

# Dituri natyre 2

Planifikimi vjetor  
dhe modele ditaresh

BOTIME



# PLANIFIKIMI VJETOR

## FUSHA: SHKENCAT NATYRORE

### LËNDA: DITURI NATYRE

TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT PËR KLASËN E DYTË

Tematikat	Përmbajtja sipas tematikave	Orët mësimore për tematikë
<b>DIVERSITETI</b>	<b>Diversiteti i materialeve</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkëmbinjte</li> <li>• Përdorimi i shkëmbinjve</li> <li>• Dherat</li> <li>• Materialet natyrorë dhe materialet e prodhuar nga njeriu</li> </ul>	5
<b>NDËRVEPRIMET</b>	<b>Gjallesat në mjedisin e tyre</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mjediset lokale;</li> <li>• Ndikimi i mjedisit të bimëve dhe kafshëve;</li> <li>• Karakteristikat e motit</li> </ul>	7
	<b>Ndryshimet e materialeve</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndryshimi i formës së materialeve</li> <li>• Tkurrja dhe bymimi i materialeve</li> <li>• Tretja e materialeve në ujë</li> </ul>	7
	<b>Drita dhe errësira</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Burimet e dritës</li> <li>• Drita dhe errësira</li> <li>• Hija dhe ndryshimi i saj</li> </ul>	5
<b>SISTEMET</b>	<b>Elektriciteti</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Qarku elektrik</li> <li>• Elementet e qarkut elektrik</li> </ul>	7
	<b>Toka dhe hapësira</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rrotullimi i Tokës rreth boshtit</li> <li>• Ndryshimi i hijes gjatë ditës</li> </ul>	4
<b>Totali</b>		<b>35</b>

## Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

### Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

#### Nxënësi/ja:

1. Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup;
2. Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe e prezanton atë para të tjerëve.

### Kompetenca e të menduarit

#### Nxënësi/ja:

1. Gjen veçoritë e një objekti, dukurie apo ngjarje të dhënë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta;
2. Krahason objektet, materialet e paraqitura nga mësuesi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësi, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë etj. dhe tregon funksionin që kanë në natyrë apo në shoqëri;
3. Gjen dhe ndan në grupe të përbashkëta dallimet ndërmjet gjallesave, ngjarjeve, dukurive të njohura si dhe shkruan për to, të paktën gjysmë faqe fletore (rreth 250 fjalë) apo i paraqet në njërin nga format shprehëse;
4. Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës, në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna;
5. Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi në kohëzgjatje nga 3 -5 minuta.

### Kompetenca e të nxënit

#### Nxënësi/ja:

1. Përzgjedh materialet/mjetet si: letrën, plastelinën, shkopinjte, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë;
2. Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material për të realizuar një veprimtari /aktivitet /detyrë që kërkohet;
3. Parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/ detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit;
4. Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes;
5. Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shënim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa gjen zgjidhjen;
6. Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet, për përgatitjen apo pasurimin e portofolit personal;
7. Identifikon njohuritë që ka, të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo veprimtari të caktuar dhe kërkon këshilla e informacion për kapërcimin e vështirësive.

### **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**

Nxënësi/ja:

1. Përgatit një plan të thjeshtë ditor, me shkrim, vizatim, shenja apo simbole, për dy- tri aktivitete ditore, duke pasur parasysh kohën, vendin, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e detyrës;
2. Kontrollon mjetet /materialet dhe kohën, që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/ aktiviteti (në klasë, shkollë apo jashtë saj);
3. Diskuton me moshatarët për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë apo për një grup të caktuar njerëzish në raport me të tjerët apo me mjedisin që e rrethon gjatë realizimit të një aktiviteti të caktuar;
4. Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet aktiviteteve, që organizohen në shkollë me ato në shtëpi dhe i përshkruan në mënyrë individuale përmes njëres prej formave të të shprehurit duke i diskutuar në grup;
5. Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/veprimtarie në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak, në lagje/ komunitet;
6. Diskuton në grup për hapësirat e pastra, të sigurta në mjedisin që e rrethon dhe tregon të paktën një mënyrë veprimi për mbikëqyrje apo për përmirësim të gjendjes.

### **Kompetenca personale**

Nxënësi/ja:

1. Prezanton para të tjerëve rregullat themelore të higjienës personale dhe të higjienës së mjedisit në të cilin jeton dhe vepron;
2. Bën një listë me ushqimet që konsumon dhe i rendit ato sipas rëndësisë që kanë për shëndetin dhe mirëqenien e vet si dhe ndërmerr masa parandaluese për t'u mbrojtur nga sëmundjet që shkaktohen nga papastërtitë dhe përdorimi i tepruar i tyre (duke përdorur një nga format shprehëse si: shkrim, vizatim etj.);
3. Tregon mënyrën e shfrytëzimit dhe menaxhimit të kohës së lirë në të mirën e shëndetit dhe mirëqenies së vet duke ndarë përvojat me të tjerët;
4. Përkujdeset për një mjedis të shëndetshëm gjatë realizimit të një aktiviteti, duke krijuar kushte të përshtatshme pune (ajrosje, ndriçim, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

### **Kompetenca qytetare**

Nxënësi/ja:

1. Prezanton rolet dhe detyrat e anëtarëve të familjes së vet apo të ndonjë grupi, në të cilin është pjesëmarrës (grup loje, aktiviteti), tregon detyrat dhe i diskuton me bashkëmoshatarët;
2. Diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat në grup, në klasë, për realizimin e aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.;
3. Arsyeton nevojën e zbatimit të rregullave në lojë, në klasë dhe shkollë, në rrugë apo në familje dhe paraqet pasojat e moszbatimit të ndonjë rregulli në shembullin e caktuar;
4. Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke e dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar;

5. Identifikon personat dhe shërbimet e nevojshme nga të cilët kërkohet ndihma në situatat e rrezikut për shëndetin e vet, fizik apo mendor.

### Kompetenca digjitale

Nxënësi/ja:

1. Njeh disa mjete të thjeshta të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;
2. Tregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësuesi), me përmbajtje jo më shumë se një faqe teksti;
3. Realizon punime origjinale, vetjake duke përdorur figurat e gjetura nga burime informacioni, si një formë për të shprehur emocionet e tyre;
4. Kupton rëndësinë e ruajtjes së të dhënave individuale (emri, mbiemri, adresa e shtëpisë, moshë) dhe mospublikimit të tyre në asnjë burim informacioni të palicencuar.

## Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës

### TEMATIKA: DIVERSITETI

#### Përshkrimi i tematikës:

Kjo tematikë nënvizon rëndësinë e ruajtjes së shumëllojshmërisë në natyrë. Për të kuptuar më mirë botën në të cilën jeton, njeriu përpiqet të organizojë botën e gjallë dhe jo të gjallë. Ka disa tipare të përbashkëta që lidhin të gjitha qeniet e gjalla dhe faktorë unikë në botën jo të gjallë që e ndihmojnë njeriun t'i klasifikojë ato. Ruajtja e shumëllojshmërisë siguron mbijetesën dhe vazhdimësinë e jetës.

Në fokus të kësaj tematike në këtë shkallë është diversiteti i kafshëve, bimëve, mikroorganizmave, mjedisit natyror, lëndëve dhe vetive e karakteristikave të tyre.

#### Rezultatet e të nxënit

##### *Shkathësitë dhe procedurat*

Nxënësi/ja:

- vëzhgon dhe identifikon:
  - a) llojet e shkëmbinjve;
  - b) llojet e dherave;
- përshkruan përdorimet e shkëmbinjve të ndryshëm;
- identifikon dhe klasifikon materiale të përbëra nga lëndë natyrore dhe ato të prodhuara nga njeriu;
- përshkruan përdorimet e materialeve të ndryshme;
- realizon praktikisht prodhimin e disa materialeve të ndërtimit, si p.sh. tullave prej balte etj.
- zbulon praktikisht përbërësit e dheut.

##### *Qëndrimet dhe vlerat*

Nxënësi/ja:

- tregon kuriozitet për vetitë dhe përdorimet e materialeve, shkëmbinjve dhe dherave të ndryshme;
- demonstron bashkëpunim gjatë punës në grup për përgatitjen e materialeve të prodhuara nga njeriu, si p.sh. tullave prej balte;

- vlerëson burimet e ndryshme të informacionit (enciklopedi, ilustrime, website etj) që mbështesin kërkimin e tij.

## TEMATIKA: NDËRVEPRIMET

### **Përshkrimi i tematikës:**

Studimi i ndërveprimit midis dhe brenda sistemeve zhvillon të kuptuarit e mjedisit dhe rolit të njeriut në të. Ndërveprimet ndodhin brenda një organizmi, midis organizmave, si dhe midis organizmave dhe mjedisit. Ndërveprimi i njeriut me mjedisin drejton zhvillimin e shkencës dhe të teknologjisë. Në të njëjtën kohë, shkenca dhe teknologjia ndikojnë në mënyrën se si njeriu ndërvepron me mjedisin. Të kuptuarit e këtij ndërveprimi e ndihmon nxënësin të kuptojë më mirë pasojat pozitive dhe negative të veprimeve të tij dhe të jetë përgjegjës për to.

Tematika fokusohet te ndërveprimi brenda dhe ndërmjet bimëve, kafshëve, njeriut, mjedisit, mikroorganizmave, atmosferës, sistemit diellor dhe Tokës, forcave, shkencës dhe teknologjisë.

### **Rezultatet e të nxënit**

Ndërveprimet e gjallesave midis tyre dhe me mjedisin.

#### **Shkathësitë dhe proceset**

Nxënësi/ja:

- identifikon ngjashmëritë dhe ndryshimet midis mjediseve të ndryshme lokale;
- tregon disa mënyra me anë të të cilave mjediset lokale ndikojnë te bimët dhe kafshët që jetojnë aty;
- mbledh të dhëna duke përdorur burime dytësore për të kuptuar si të kujdesemi për mjedisin;
- kryen vëzhgime për motin dhe regjistron të dhënat;
- diskuton për karakteristikat e motit mbështetur në vëzhgimet.

### **Qëndrimet dhe vlerat.**

Nxënësi/ja:

- ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përfutuara nga vëzhgimet individuale;
- vlerëson burimet dytësore të informacionit që mbështesin kërkimin e tij/saj rreth kujdesit të njeriut në mjedis;
- tregon interes për të mbledhur informacione dhe kontribuar me përgjegjshmëri në kujdesin ndaj mjedisit.

### **Rezultatet e të nxënit**

#### **Ndryshimet e materialeve**

#### ***Shkathësitë dhe proceset***

Nxënësi/ja:

- përshkruan ndryshimet që ndodhin te materialet, si rezultat i përkuljes, përdredhjes, zgjatje, ngjeshjes;
- eksploron dhe përshkruan mënyrën se si ndryshojnë materialet kur nxehen dhe kur ftohen, si p.sh. akulli, ushqimet, qiri etj.;
- identifikon materialet që treten në ujë;
- eksperimenton dhe përshkruan aftësinë tretëse të trupave.

## Qëndrimet dhe vlerat

Nxënësi/ja:

- demonstron dhe vlerëson zbatimin e rregullave të sigurisë gjatë punës për nxehjen e materialeve;
- skicon dhe kryen një eksperiment të ndershëm, si p.sh për tretjen e lëndëve në ujë, nxehjen dhe ftohjen e tyre etj.;
- diskuton mbi rolin dhe rëndësinë e kripës si dhe mënyrat e nxjerrjes së saj.

## Rezultatet e të nxënit

### Drita dhe errësira

#### *Shkathësitë dhe proceset.*

Nxënësi:

- zbulon burime të ndryshme drite, përveç Diellit;
- bën dallimin mes burimeve natyrore dhe artificiale të dritës;
- koncepton errësirën si mungesë e dritës;
- përshkruan si formohet hija;
- bën lidhjen mes formës e madhësisë së hijes dhe pozicionit të objektit e burimit të dritës;
- demonstron pasqyrimin e dritës;
- tregon rolin e mjeteve mbrojtëse të syrit ndaj dritës së fortë.

## Qëndrimet dhe vlerat

- planifikon në grup një veprimtari, ku shfrytëzon forma të ndryshme të hijeve, si p.sh. një shfaqje me hije, ekspozitë etj.;
- skicon një provë për të gjetur pse ndryshon madhësia e hijes dhe forma e saj (pozicioni i burimit dhe i objektit).

## TEMATIKA: SISTEMET

**Përshkrimi i tematikës:** Një sistem përfaqëson një tërësi pjesësh të cilat punojnë së bashku për të kryer një funksion të caktuar. Ka sisteme në natyrë, si dhe sisteme të ndërtuara nga njeriu. Shembuj të sistemeve në natyrë janë sistemet e trupit të njeriut. Shembuj të sistemeve të ndërtuara nga njeriu janë sistemet elektrike. Njohja e sistemeve e lejon njeriun të kuptojë si funksionon secila pjesë e sistemit dhe si ndërveprojnë me njëra-tjetrën për të kryer një funksion të caktuar.

Kjo temë përqendrohet tek studimi i sistemit të bimëve dhe kafshëve, sistemit elektrik, sistemeve të matjes, sistemit Tokë-hapësirë.

## Rezultatet e të nxënit

### Elektriciteti

#### *Shkathësitë dhe proceset*

Nxënësi/ja:

- zbulon nga se përbëhet një qark elektrik;
- përshkruan rolin e secilit element të qarkut elektrik si dhe të sinjalizuesit;
- tregon se:
  - a) elektriciteti merret nga rrjeti ose nga bateritë;

- b) zbatime të qarqeve elektrike në shtëpi ose në klasë;
- vëzhgon se telat me materiale të ndryshme e përcjellin në mënyra të ndryshme elektricitetin;
- ndërton:
  - a) një qark të thjeshtë elektrik;
  - b) një çelës për një qark elektrik të thjeshtë;
  - c) një lodër që përdor elektricitetin.

**Qëndrimet dhe vlerat**

Nxënësi/ja:

- vlerëson rolin e elektricitetit në jetën e përditshme;
- demonstron dhe vlerëson zbatimin e rregullave të sigurisë gjatë punës me elektricitet;
- punon në grup për hartimin e një posterit mbi rregullat e sigurisë gjatë punës me elektricitet dhe e prezanton atë.

**Rezultatet e të nxënit**

Toka dhe hapësira

***Shkathësitë dhe proceset***

Nxënësi/ja:

- përshkruan formimin e ditës dhe natës si pasojë e rrotullimit të Tokës rreth boshtit të saj;
- zbulon:
  - a) nëse lëviz Dielli apo Toka;
  - b) si ndryshojnë hijet;
- demonstron se hiya ndryshon madhësinë dhe formën si pasojë e rrotullimit të Tokës rreth boshtit.

**Qëndrimet dhe vlerat**

Nxënësi/ja:

- punon në grup për krijimin e një maketi që tregon formimin e ditës dhe natës si pasojë e rrotullimit të Tokës rreth boshtit të saj.

**SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES SË LËNDËS**

Tematika/Shkalla 1	Diversiteti	Ciklet	Ndërveprimet	Sistemet	Gjithsej:
Klasa e dytë	5 orë		19 orë	11 orë	35 orë



## Shpërndarja vjetore e përmbajtjes së lëndës

Tematika	Tremujori 1 12 orë Temat mësimore	Tremujori 2 12 orë Temat mësimore	Tremujori 3 11 orë Temat mësimore
Ndërveprimet	Jashtë klasës 1. Vende të ndryshme për të jetuar 2. Vende të ndryshme për të jetuar 3. A mund të kujdesemi për mjedisin? 4. Moti 5. Moti i pazakontë 6. Kontrolloni përparimin tuaj 7. Kontrolloni përparimin tuaj	Ndryshimi i materialeve 1. Ndryshimi i formës së materialeve 2. Përkulja dhe përdredhja 3. Materialet elastike 4. Nxehja dhe ftohja 5. Pse është i kripur deti? 6. Pse është i kripur deti? 7. Kontrolloni përparimin tuaj	
Diversiteti	Shkëmbinjte 8. Çfarë janë shkëmbinjte? 9. Përdorimi i shkëmbinjve 10. Dheu 11. Materiale të tjera natyrore 12. Kontrolloni përparimin tuaj	<b>Drita dhe errësira</b> 8. Burimet e dritës 9. Errësira 10. Formimi i hijeve 11. Format e hijes 12. Kontrolloni përparimin tuaj	
Sistemet			Elektriciteti 1. Elektriciteti rreth nesh 2. Mbrojtja nga elektriciteti 3. Ndërtimi i qarkut 4. Ndërtimi i qarkut 5. Përdorimi i motorëve dhe sinjalizuesve 6. Çelësat 7. Kontrolloni përparimin tuaj  <b>Toka dhe Dielli</b> 8. Dita dhe nata 9. A lëviz dielli? 10. Ndryshimi i hijeve 11. Kontrolloni përparimin tuaj

## Planifikimi 3- mujori i parë

Fusha: Shkencat e natyrës

LËNDA: DITURI NATYRE

Nr	Tematikat	Tema mësimore	Situata e parashikuar e të nxënësve	Metodologjia	Vlerësimi	Burimet e materialeve didaktike	Data	Dita
1.		Vende të ndryshme për të jetuar	Studiojmë mjediset e ndryshme	Përmbledhje pohim mbështetje	Tregon disa mënyra me anë të të cilave mjediset lokale ndikojnë te bimët dhe kafshët.	Programi lëndor Teksti shkollor fletorja e punës, Fletët e aktivitetit libri i mësuesit,		
2.		Vende të ndryshme për të jetuar	Krahasimi i dy mjediseve të ndryshme	Vëzhgim në natyrë	Identifikon ngjashmëritë dhe ndryshimet midis mjediseve të ndryshme.	enciklopedi,		
3.		A mund të kujdesemi për mjedisin?	Mjedisi ynë	Kërkim për zgjidhje problemi	Vlerëson mënyra të ndryshme të kujdesit ndaj mjedisit.	tabak letre,		
4.	<b>Ndërveprimet</b> a- Jashrë klasës	Moti	Moti sot	Projekt	Prezanton në forma të ndryshme, duke përdorur fjalorin e përshatshëm.	ngjyra, lapsa,		
5.		Moti i pazakontë	Si të mbrohemi në mot të pazakontë?	Hetim Lojë	Vëzhgon, regjistron dhe vlerëson kushtet e motit.	makete, aparat fotografik,		
6.		Kontrolloni përparimin tuaj	Unë di...	Diskutim	Prezanton në forma të ndryshme, duke përdorur fjalorin e përshatshëm.	organizues grafik, video-projektor		
7.		Kontrolloni përparimin tuaj	Unë di...	Projekt	Komunikon dhe bashkëpunon me të tjerët.			

Nr	Tematikat	Tema mësimore	Situata e para-shikuar e të nxëniet	Metodologjia	Vlerësimi	Burimet e materiale didaktike	Data	Dita
8.		Çfarë janë shkëmbinjtë?	Krahasonjmë shkëmbinjtë	Hetim	Tregon dallimin ndërmjet llojeve të ndryshme të shkëmbinjve.	enciklopedi, mostra të ndryshme shkëmbinjsh		
9.		Përdorimi i shkëmbinjve	Përdorimi i materialeve shkëmbore	Përmbledhje pohim mbështetje Kërkim	Vlerëson përdorime të ndryshme të materialeve të ndryshme shkëmbore.	lupë dore, fletë aktiviteti, website,		
10.	Diversiteti a- Shkëmbinjtë	Dheu	Gjejmë materiale shkëmbore në tokë	Hetim	Zbulon praktikisht përbërësit e dheut.	mostra të ndryshme tokash fara bimësh,		
11.		Materiale të tjera natyrore	Gjetja e materialeve	Hetim	Klasifikon materiale të përbëra nga lëndë natyrore dhe ato të prodhuara nga njeriu.	ambienti përreth		
12.		Kontrolloni përpërimin tuaj	Unë di...	Projekt	Prezanton në forma të ndryshme duke përdorur fjalorin e përshtatshëm.			

## Planifikimi 3- mujori i dytë

Fusha: Shkencat e natyrës

LËNDA: DITURI NATYRE

Nr	Tematikat	Tema mësimore	Situata e parashikuar e të nxënët	Metodologjia	Vlerësimi	Burimet e materiale didaktike	Data	Dita
13.		Ndryshimi i formës së materialeve	Ngjeshja	Lojë Hetim	Tregon se si ndryshon forma e disa materialeve gjatë ushtrimit të një force shrypëse mbi to.	Programi lëndor. Teksti shkollor, Fletëtorja e punës, Fletët e aktivitetit, Libri i mësuësit, plastelinë, brumë, llastikë, materiale elastike,		
14.		Përkulja dhe përdredhja	Luajmë me brumë	Lojë	Përkruan ndryshimet që ndodhin te materialet, si rezultat i përkuljes, përdredhjes, zgjatjes, ngjeshjes.	trupa të ndryshëm, enciklopedi, materiale të		
15.	<b>Ndërveprimet</b> b- Ndryshimi i materialeve	Materialet elastike	Tërheqja e llastikut	Kërkim Përfundime	Përkruan se si mund të ndryshohen format e disa materialeve nëpërmjet tërheqjes.	ndryshme ushqimore, tabak letre, ngjyra, lapsa, video-projektor,		
16.		Nxehja dhe ftohja	Ngrohja e ushqimeve	Vëzhgim	Skicon dhe kryen një eksperiment të saktë, si p.sh për tretjen e lëndëve në ujë, nxe-hjen dhe ftohjen e tyre etj.			
17.		Pse është i kripur deti?	Tretja e materialeve në ujë	Hetim Lojë	Eksperimenton dhe përkruan aftësinë tretëse të trupave.			
18.		Pse është i kripur deti?		Diskutim				
19.		Kontrolloni përpërimin tuaj	Unë di...	Projekt	Prezanton në forma të ndryshme, duke përdorur fjalorin e përshtatshëm.			

Nr	Tematikat	Tema mësimore	Situata e parashikuar e të nxënit	Metodologjia	Vlerësimi	Burimet e materialit didaktike	Data	Dita
20.	<b>Ndërveprimet</b> c- Drita dhe errësira	Burimet e dritës	Zbulojmë burime të ndryshme drite	Hetim	Zbulon burime të ndryshme drite, përveç Diellit.	enciklopedi, objekte për t'u testuar, burime të ndryshme drite, lupë dore, fletë aktiviteti, website,		
21.		Errësira	A mund të shohim në errësirë?	Hetim Përfundim	Koncepton errësirën si mungesë e dritës.	forma të ndryshme për të formuar hijet e tyre		
22.		Formimi i hijeve	Në sheshin e lojtarave	Lojë	Përshkruan si formohet hija.			
23.		Format e hijes	Formojmë hije	Veprimtari diskutim	Bën lidhjen mes formës e madhësisë së hijes dhe pozicionit të objektit e burimit të dritës.			
24.		Kontrolloni përpunimin tuaj	Unë di...	Projekt	Prezanton në forma të ndryshme, duke përdorur fjalorin e përshtatshëm.			

## Planifikimi 3- mujori i tretë

Fusha: Shkencat natyrore

LËNDA: DITURI NATYRE

Nr	Tematikat	Tema mësimore	Situata e parashikuar e të nxënit	Metodologjia	Vlerësimi	Burimet e materialeve didaktike	Data	Dita
20.		Elektriciteti rreth nesh	E përdor apo jo elektricitetin?	Kërkim Ditari dy pjesësh	Vlerëson rolin e elektricitetit në jetën e përditshme.	Programi lëndor. Teksti shkollor, Fletëtorja e punës, Fletët e aktivitetit,		
26.		Mbrojja nga elektriciteti	Si të mbrohemi nga elektriciteti?	Krijimi i një posteri	Punon në grup për hartimin e një posteri mbi rregullat e sigurisë gjatë punës me elektricitet dhe e prezanton atë.	Libri i mësuesit, bateri/pilë, tabak letre, ngjyra, lapsa, mbajtëse baterish, llambë, tel		
27.		Ndërtimi i qarkut	Si mund ta ndezësh llambën?	Lojë Kërkim Përfundime	Zbulon nga se përbehet një qark elektrik. Përkrauan rolin e secilit element të qarkut elektrik, si dhe të sinjalizuesit.	përçues, motor, karton, gërrshërë,		
28	<b>Sistemet a- Elektriciteti</b>	Ndërtimi i qarkut						
29.		Përdorimi i motorëve dhe sinjalizuesve	Si të bëjmë një ventilator?	Vepimtari Diskutim	Ndërton një lodër që përdor elektricitetin.	video-projektor, enciklopedi,		
30.		Çelësat	Ndize, fike	Vepimtari Prezantim	Ndërton një çelës për një qark elektrik të thjeshtë.			
31.		Kontrolloni përpunimin tuaj	Unë di...	Lojë	Prezanton në forma të ndryshme duke përdorur fjalorin e përshtatshëm.			

Nr	Tematikat	Tema mësimore	Situata e parashikuar e të nxënësve	Metodologjia	Vlerësimi	Burimet e materialeve didaktike	Data	Dita
32.		Dita dhe nata	Dita dhe nata	Veprimtari Prezantim Përfundime	Zbulon nëse lëviz Dielli apo Toka.	globe, burime drite, orë,		
33.		A lëviz dielli?				foto ilustrimesh, enciklopedi, fletë aktiviteti, website,		
34.	<b>Sistemet b- Toka dhe Dielli</b>	Ndryshimi i hijëve	A lëvizin hijet?	Lojë Veprimtari	Demonstron se hija ndryshon madhësinë dhe formën, si pasojë e rrotullimit të Tokës rreth boshtit.			
35.		Kontrolloni për- parimin tuaj	Unë di...	Projekt	Prezanton në forma të ndryshme, duke përdorur fjalorin e përshtatshëm.			

## Kapitulli 1: Jashtë klasës

### Ora 1

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 2	Data
<b>Tema mësimore:</b> Vende të ndryshme për të jetuar (ora 1)		<b>Situata e të nxënit:</b> Studiojmë mjedisë të ndryshme	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Identifikon ngjashmëritë dhe ndryshimet midis mjediseve të ndryshme lokale.</li> <li>- Tregon disa mënyra me anë të të cilave mjediset lokale ndikojnë te bimët dhe kafshët që jetojnë aty.</li> <li>- Ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përfuara nga vëzhgimet individuale.</li> </ul>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Identifikon ngjashmëritë dhe ndryshimet midis mjediseve rrethuese dhe mëson disa nga mënyrat që ndikojnë mbi kafshët dhe bimët që gjenden në ato mjedisë.</li> <li>- Përdor përvojën e drejtpërdrejtë për të bërë krahasimet ndërmjet mjediseve.</li> </ul>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> mjedis i ndryshëm, gjallesa shumë të vogla</p>	
<p><b>Burimet:</b> mjedisi rreth shkollës, materiale mbështetëse për veprimtarinë.</p> <p><b>Mjete:</b> fletë pune, figura kafshësh e bimësh, lapsa, ngjyra</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Shkencat sociale (Gjeografi)</p>	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <p><i>Diskutim për njohuritë paraprake:</i> Nxënësve u drejtohet pyetja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për çfarë kanë nevojë bimët dhe kafshët për të jetuar?</li> </ul> <p>Shkruhet në tabelë fjala <b>BIMË</b> dhe fjala <b>KAFSHË</b>. Mendimet e nxënësve shkruhen në tabelë duke formuar hartën e mendimit. Duhet të theksohet nevoja e bimës për ujë dhe dritë si dhe nevoja e kafshëve për ujë, strehë e ushqim.</p> <p><i>Përmbledhja pohim mbështetje:</i> Organizohen nxënësit të punojnë për 5 minuta në dyshe dhe të përfytyrojnë sa më shumë mjedisë jetësore. Përgjigjet e nxënësve shënohen në tabelë dhe diskutohen me të gjithë klasën mbi ngjashmëritë dhe ndryshimet ndërmjet mjediseve të identifikuar nga nxënësit (të thata, me lagështi, me dritë, pa dritë).</p> <p>Punohet fq. 6 e librit. Diskutohen ngjashmëritë dhe ndryshimet midis këtyre mjediseve dhe diskutohen rreth faktit se si ndikojnë ato mbi kafshët dhe bimët që jetojnë në to. Nxënësit vëzhgojnë figurat e një ujëvare si edhe të një mjedisi të thatë shkretëtire dhe shqyrtojnë nëse ato mund të shërbejnë si vende të përshtatshme jetese për kafshë dhe bimë të ndryshme. Nëpërmjet fletëve të punës, u prezantohen nxënësve figura kafshësh që mund të jetojnë në mjedisë të ndryshme, dhe figura të kafshëve që jetojnë vetëm në një mjedis.</p> <p><i>Fletë pune 1.1c</i> është e përshtatshme për nxënësit me arritje të ulëta, ndërsa <i>Fletë pune 1.1d</i> për ata me arritje të larta, të cilëve u kërkohet të gjejnë dhe kafshë të tjera, që mund të jetojnë në shumë mjedisë ose vetëm në mjedisë të caktuara.</p> <p>Diskutohen së bashku përfundimet e fletëve të punës. Nxënësve me arritje të larta mund t'u kërkohet të shpjegojnë faktin se pse disa kafshë mund të jetojnë vetëm në mjedisë të caktuara.</p>			



<p><b>Vlerësimi:</b> Tregimin e disa mënyrave me anë të të cilave mjediset lokale ndikojnë te bimët dhe kafshët që jetojnë aty; identifikimin e ngjashmërive dhe ndryshimeve midis mjediseve të ndryshme; përcaktimin e varësisë ndërmjet llojit të mjedisit me kafshët e bimët që jetojnë në to; prezantimin e disa mënyrave me anë të të cilave mjediset lokale ndikojnë te bimët dhe kafshët që jetojnë aty .</p>	
<p><b>Detyra:</b> Nxënësit zgjedhin sipas dëshirës njërën prej detyrave:                  -Të modelojnë një kafshë të re imagjinare që mund të jetojë në një mjedis të veçantë, p.sh.; në një shkretëtirë të nxehtë apo në një mal me dëborë.                  -Të gjejnë nga burime te ndryshme kafshë të tjera që mund të jetojnë në shumë mjedise ose vetëm në mjedise të caktuara.</p>	<p><b>Refleksion:</b> trego një prej mjediseve që të bën të ndjehesh mirë.</p>
<p><b>Shënim:</b> Në varësi të kohës dhe mundësive mësuesi mund të organizojë nxënësit për të zhvilluar një vëzhgim në oborrin e shkollës. Aty do të identifikojnë lloje të ndryshme mjedisesh. Në dyshe nxënësit mbajnë shënime mbi gjetjet (llojin e mjedisit që identifikojnë si dhe të paktën një tregues për llojin). Diskutohen së bashku gjetjet.                  -Nxiten nxënësit që të bëjnë sugjerime rreth mënyrës se si duhet të mblidhet informacioni (enciklopedi/ libra të ndryshëm/ internet).                  -Në klasë ndërtohet një poster ku të përfshihet fjalori apo gjuha e përdorur që lidhet me mjedisin. Kjo do t'u mundësojë nxënësve që të plotësojnë në fletën murale, për çdo temë të re të kapitullit, fjalët e reja. Diskutohet me gjithë klasën rreth kuptimit të tyre.</p>	

## Ora 2

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 2	Data
<p><b>Tema mësimore:</b> Vende të ndryshme për të jetuar (ora 2)</p>		<p><b>Situata e të nxënit:</b> Krahasimi i dy mjediseve të ndryshme</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Identifikon ngjashmëritë dhe ndryshimet midis mjediseve të ndryshme lokale.</li> <li>- Tregon disa mënyra me anë të të cilave mjediset lokale ndikojnë te bimët dhe kafshët që jetojnë aty.</li> <li>- Ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përfutuara nga vëzhgimet individuale.</li> </ul>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Identifikon ngjashmëritë dhe ndryshimet midis mjediseve rrethuese dhe mëson disa nga mënyrat që ndikojnë mbi kafshët dhe bimët që gjenden në ato mjedise.</li> <li>- Mbledh prova nëpërmjet vëzhgimeve, ndërsa përpiqet t'i përgjigjet një pyetjeje shkencore.</li> <li>- Përdor përvojën e drejtpërdrejtë në krahasimin e mjediseve.</li> <li>- Zbulon nëse testimi mund të mos jetë i vlefshëm.</li> <li>- Kryen dhe regjistron vëzhgime.</li> <li>- Kryhen matje të thjeshta për të mbledhur prova.</li> </ul>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> mjedis i ndryshëm, mat, gjallesa shumë të vogla, regjistroj</p>	

<p><b>Burimet:</b> mjedisi rreth shkollës, materiale mbështetëse për veprimtarinë.</p> <p><b>Mjete:</b> fletë pune, mjet praktik për matjen e sipërfaqes (litar/ shirit letre/ vizore), lapsa, ngjyra, aparat fotografik</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Shkencat sociale (Gjeografi)</p>
<p>Nxënësit në dyshe për pak minuta i tregojnë njëri-tjetrit përfundimet e detyrave të shtëpisë, ndërkohë që veprimtaria ndiqet në të gjitha tavolinat.</p> <p><i>Vëzhgim në natyrë:</i> Nxënësve u prezantohet veprimtaria që do të kryejnë këtë orë:</p> <p>-Sot, në oborrin e shkollës sonë, do të studiohen dy mjedise të ndryshme. Çfarë kafshësh dhe bimësh prisni të shihni atje, të mëdha apo të vogla?</p> <p>U tregohet nxënësve që krijesat e vogla janë pjesë e rëndësishme e çdo mjedisi jetësor. Nxënësit sugjerojnë se cilin prej dy mjedisëve të ndryshme dëshirojnë që të hetojnë. Që të jetë sa më e ndershme, zonat që krahasohen duhet të jenë afërsisht të njëjta në madhësi. Shpjegohet matja e sipërfaqeve nga nxënësit.</p> <p>Paralajmërohen nxënësit për kujdesin ndaj shëndetit pasi ndonjëherë materiali bimor apo edhe lëkura e kafshëve mund të jenë të dëmshme për njeriun.</p> <p>U kërkohet nxënësve të mendojnë një pyetje që kërkon përgjigje dhe shkruhet në dërrasën e klasës. P.sh.:</p> <p>- Si ndikon mjedisi në numrin dhe llojin e kafshëve që jetojnë në atë mjedis?</p> <p>Të ndarë në grupe, nxënësit mbledhin prova nëpërmjet vëzhgimeve. Gjatë punës, diskutohet me nxënësit për mënyrën se si ata do të regjistrojnë dhe krahasojnë vëzhgimet e tyre. Këtu do të përdoret <i>Fleta e punës 1.1a</i> (e cila është më e përshtatshme për nxënësit me arritje më të ulëta) ose <i>Fleta e punës 1.1b</i> (e cila është më e përshtatshme për nxënësit me arritje më të larta).</p> <p>Nxënësit nxiten për të vëzhguar me kujdes gjithë, krijesat e vogla e kështu me radhë.</p> <p><i>Përfundimet e kërkimit:</i> Në fund të orës diskutohet me nxënësit rreth asaj që kanë zbuluar. A gjetën ata numra apo lloje të ndryshme të jetës së egër në çdo mjedis? A vëzhguan nxënësit sipërfaqe me madhësi të njëjtë? A vëzhguan ata çdo sipërfaqe për të njëjtin interval kohor? Nëse gjetën shumë krijesa të vogla apo të mëdha, zogj apo flutura, në një zonë të caktuar. A vëzhguan ata me të njëjtin intensitet në të dyja zonat? Nxënësit me arritje më të larta mund të diskutojnë rreth faktit nëse krahasimi është i drejtë.</p> <p>Nxënësit i jepen përgjigje pyetjes/ve të menduara para kërkimit: Si ndikon mjedisi në numrin dhe llojin e kafshëve që jetojnë në atë mjedis?</p>	
<p><b>Vlerësimi:</b> Mund të shkruhet në tabelë ose nxënësve mund t’u shpërndahen fletë ku shkruhet: “Unë mund të identifikoj ngjashmëritë dhe ndryshimet midis mjedisëve rrethuese.” “Unë mund të diskutoj rreth disa mënyrave në të cilat ngjashmëritë dhe ndryshimet midis mjedisëve rrethuese ndikojnë mbi kafshët dhe bimët që rriten në to.” “Unë mund të parashikoj se çfarë do të ndodhë kur të vendos se çfarë do të bëj”. Pasi tregohen thëniet, u kërkohet nxënësve se sa pajtohen ata me këto thënie në një shkallë nga 1-5, ku 5 tregon”plotësisht dakord” dhe 1 tregon “aspak dakord”.</p>	
<p><b>Detyra:</b> Punimi i detyrës së fq. 10 të <i>Fletores së punës</i>.</p>	<p><b>Refleksion:</b> Nxënësit mund të reflektojnë mbi punën e bërë prej tyre gjatë veprimtarisë, duke përmendur dy gjëra që ata i bënë mirë dhe një gjë që do të pëlqenin ta bënin më mirë.</p>
<p><b>Shënim:</b> Jepuni këtyre nxënësve pyetje të hapura për të diskutuar rreth veprimtarisë, të tilla si: ‘Ku mund të gjenden krijesat e vogla? Nxënësit mund të nxiten me shembuj konkretë, p. sh.; ‘A keni parë se çfarë kishte poshtë këtij trangu?’</p> <p>Ndihmoni nxënësit, duke përdorur fjalorin e duhur; për këtë mund të përdoret <i>Fleta mbështetëse 1.1b</i>.</p>	

**Ora 3**

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 2	Data
<b>Tema mësimore:</b> A mund të kujdesemi për mjedisin?		<b>Situata e të nxënit:</b> Mjedisi ynë	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbledh të dhëna duke përdorur burime dytësore për të kuptuar si të kujdesemi për mjedisin.</li> <li>- Ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përfuara nga vëzhgimet individuale.</li> <li>- Vlerëson burimet dytësore të informacionit që mbështesin kërkimin e tij/saj rreth kujdesit të njeriut në mjedis.</li> <li>- Tregon interes për të mbledhur informacione dhe kontribuar me përgjegjshmëri në kujdesin ndaj mjedisit.</li> </ul>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kupton mënyrat e kujdesit ndaj mjedisit rrethues dhe se si mund të përdoren burimet dytësore.</li> <li>- Përdor burime të thjeshta të marrjes së informacionit.</li> <li>- Kryen dhe regjistron rezultatet e vëzhgimeve.</li> <li>- Mbledh prova nëpërmjet vëzhgimeve, ndërsa përpiqet t'i përgjigjet një pyetjeje shkencore.</li> <li>- Përdor përvojën e drejtpërdrejtë për mbledhjen e provave.</li> <li>- Parashikon se çfarë do të ndodhë përpara se të vendosë se çfarë do të bëjë.</li> <li>- Bën sugjerime për mbledhjen e provave.</li> </ul>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> mbeturina, ujëra të zeza, mbrojtje, grupet mjedisore</p>	
<p><b>Burimet:</b> mjedisi rreth shkollës, materiale mbështetëse për veprimtarinë.</p> <p><b>Mjete:</b> fletë pune, fletore/bllok shënimesh, lapsa, ngjyra, aparat fotografik</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Shkencat sociale (Gjeografi)</p>	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <p><i>Diskutim për njohuritë paraprake:</i> Udhëzohen nxënësit të vëzhgojnë figurën e librit në fq. 8 dhe të tregojnë rreth asaj që shohin në të. Shtrohet pyetja: -Si mendoni, a dëmtohen gjallesat pranë plazhit nga mbeturinat dhe ujërat e zeza? Si mund t'i mbrojmë gjallesat? Gjatë diskutimit shpjegohen fjalët kyçe.</p> <p><i>Kërkim për zgjidhje problemi:</i> Ftohen nxënësit të bëjnë një vizitë jashtë ambienteve të klasës. Nxënësit mund të sugjerojnë ide rreth asaj se çfarë do të vëzhgojnë përpara se të largohen nga klasa. Sapo të dalin në mjedis të hapur, nxënësit në dyshe duhet të identifikojnë çdo dëmtim të mjedisit rrethues. Nxënësit duhet të mbledhin prova me qëllim që t'i përgjigjen pyetjes: “Me ç'mënyra e dëmtojnë njerëzit mjedisin?” Nxënësit mund të regjistrojnë vëzhgimet e tyre nëpërmjet formave të ndryshme si: me video, me vizatim, me regjistrime zanore apo të shkruara. Si mjet regjistruer për këtë mund të përdoret <i>Fleta e punës 1.2a</i>. Nxënësit me arritje më të ulëta do të gjejnë dy shembuj të dëmtimit të mjedisit dhe mbështeten me pyetje të tilla si: “A janë mbeturinat të dobishme për jetesën e kafshëve?”. Për nxënësit me arritje më të larta pritet që të gjejnë shembuj të tjerë të dëmtimit të mjedisit, si edhe të sugjerojnë mënyra që këta shembuj të mos përsëriten. Nxiten këta nxënës që të shpjegojnë pse këto veprime do të kenë ndikim pozitiv mbi mjedis.</p>			

*Diskutim:* Në fund të veprimtarisë nxënësit mblidhen për të diskutuar rreth gjetjeve dhe faktit se si duhet të kujdesen më mirë njerëzit për mjedisin rrethues. Si mund të ndalet dëmtimi i mjedisit? Si mund të vihen gjërat në vendin e duhur? Si mund të ndihmojnë nxënësit? Nxënësit plotësojnë dy ushtrimet e para të *Fletës së punës 1.2b* me idetë e tyre. Disa prej tyre i prezantojnë ato me dëshirën e tyre.

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për përshkrimin në mënyra të ndryshme të kujdesit ndaj mjedisit. Për argumentimin, sepse veprimet e tyre kanë një ndikim pozitiv.

Nxënësit mund të vetëvlerësojnë punën e njëri-tjetrit, të kryer gjatë veprimtarisë.

A vërejnë të gjithë nxënësit të njëjtat gjëra? Sa mirë i regjistrojnë nxënësit vëzhgimet e tyre? A e kanë përdorur mjaftueshëm informacionin e marrë nga burimet e thjeshta të informacionit gjatë mësimin të kësaj teme?

**Detyra:** Punimi i fq. 11 *Fletore pune*

-Nxënësit zgjedhin me dëshirë të punojnë ushtrimin 3 të *Fletës së punës 1.2b*.

**Refleksion:** trego një mënyrë konkrete si do të ndikosh për të mirë në mjedis.

**Shënim:** Detyra e dytë e shtëpisë mund të jetë detyrë për nxënësit me arritje të larta.

## Ora 4

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 2	Data
<b>Tema mësimore:</b> Moti		<b>Situata e të nxënit:</b> Moti sot	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kryen vëzhgime për motin dhe regjistron të dhënat.</li> <li>- Diskuton për karakteristikat e motit mbështetur në vëzhgime.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b>		<b>Fjalë kyçe:</b> temperaturë, mot, ftohtë, ngrohtë, me re, shi, borë, breshër, erë, njësoj, me diell, me ngricë.	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vëzhgon dhe diskuton vëzhgimet rreth motit, duke regjistruar të dhënat e mbledhura për kushtet e motit.</li> <li>- Mbledh prova nëpërmjet vëzhgimeve, ndërsa përpiqet t'i përgjigjet një pyetjeje shkencore.</li> <li>- Përdor përvojën e drejtpërdrejtë në përcaktimin dhe parashikimin e motit.</li> <li>- Bën sugjerime për mbledhjen e provave.</li> <li>- Kryen dhe regjistron vëzhgime.</li> <li>- Përdor një shumëllojshmëri mënyrash për t'u treguar të tjerëve faktet e vëna re.</li> </ul>			
<b>Burimet:</b> moti, enciklopedi		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b>	
<b>Mjete:</b> fletë pune, tabak letre, lapsa, ngjyra, aparat fotografik		Shkencat sociale (Gjeografi), Matematikë, Gjuhët (Gjuhë Shqipe)	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b>			
<i>Parashikim me terma paraprakë:</i> U jepen nxënësve fjalët kyçe: temperaturë, mot, ftohtë, ngrohtë, me re, me diell dhe kërkohet të gjejnë një lidhje ndërmjet tyre. Prezantohet tema mësimore dhe diskutohet rreth figurave të fq. 10 të librit. Gjatë diskutimit punohet kuptimi i fjalëve të tjera kyçe.			

Vazhdohet me veprimtarinë: Si është moti sot? (fq. 11 të librit). Nxënësit i japin përgjigje pyetjeve dhe më pas i diskutojnë në dyshe.

Ata nxiten të japin mendime nëpërmjet pyetjeve: Çfarë keni vënë re për motin e ditës së djeshme dhe të ditës së sotme? A mund të bëjmë një parashikim të motit për orët e mëvonshme të ditës?

**Projekt:** Jepet detyrë në grup bërja e një posteri. Kërkohej nga nxënësit që të sugjerojnë mënyra të ndryshme të regjistrimit të të dhënave të motit nëpërmjet simboleve si në *Fletën e punës 1.3a*. Udhëzohen nxënësit që të vëzhgojnë motin për 5 ditë dhe të mbajnë një ditar të të dhënave të motit nëpërmjet përdorimit të simboleve. Në secilën prej ditëve, një pjesëtar i grupit ka detyrën e plotësimit të posterit të motit në klasë. Nxënësit mund ta fillojnë këtë detyrë duke filluar që nga dita e marrjes së kësaj teme dhe më pas ta vazhdojnë detyrën përgjatë gjithë ditëve të tjera të javës, ose në shtëpi ose në shkollë.

Pjesë e kalendarit mund të jetë dhe tregimi i temperaturave. Demonstrohen mënyrat e matjes së temperaturës nëpërmjet termometrit të murit. Zhvillohen në dyshe matjet e temperaturës së ambientit dhe kryhet plotësimi i fletës së punës 1.3a. Këto matje krahasohen brenda dysheve të grupit dhe shënohen në poster.

Secili grup afishon kalendarin/poster, me përfaqësues që prezanton motin dhe parashikimin e tij.

**Vlerësimi:** Për komunikimin me të tjerët të ideve të tyre rreth motit; për vëzhgimin, regjistrimin dhe vlerësimin e kushteve të motit; për prezantimin në forma të ndryshme të tij, duke përdorur fjalorin që përshtatet me këtë temë.

Nxënësit mund të vlerësojnë posterat e njëri-tjetrit. Ata duhet të japin të paktën dy vlerësime pozitive dhe më pas një sugjerim për mënyrën se si mund të përmirësohet posteri.

**Detyra:** Punimi i fq. 12 *Fletore pune*

-Gjatë ditëve të javës sipas grupeve nxënësit do të plotësojnë kalendarin/poster që kanë në klasë.

**Refleksion:** trego një gjë të re dhe më interesanten që mësove sot.

**Shënim:** Mund të bëhen sugjerime shtesë për mbledhjen e provave rreth kushteve të motit, të cilat mund të përfshijnë matje të thjeshta të erës apo të sasisë së rënë të reshjeve. Bazuar në *Fletën e punës 1.3d*, jepen udhëzime dhe bëhen demonstrime të mjeteve të thjeshta që shërbejnë për këto matje.

## Ora 5

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 2	Data
<b>Tema mësimore:</b> Moti i pazakontë		<b>Situata e të nxënit:</b> Si të mbrohem në mot të pazakontë?	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kryen vëzhgime për motin dhe regjistron të dhënat.</li> <li>- Diskuton për karakteristikat e motit mbështetur në vëzhgimet.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b>		<b>Fjalë kyçe:</b> Toka, i pazakontë, parashikuesit e motit, stuhi, kërkim	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vëzhgon dhe diskuton vëzhgimet mbi motin, duke regjistruar të dhënat e kushteve të motit.</li> <li>- Përdor burime të thjeshta për marrjen e informacionit.</li> <li>- Diskuton rreth rreziqeve dhe mënyrave të shmangies së tyre.</li> </ul>			

<b>Burimet:</b> moti, enciklopedi, internet	<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Shkencat sociale (Gjeografi)
<b>Mjete:</b> fletë pune, tabak letre, lapsa, ngjyra	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <i>Prezantimi i detyrës:</i> “Kalendarit të motit” nga përfaqësuesit e secilit grup. <i>Harta semantike:</i> Shkruhet në tabelën e klasës “ <b>Mot i pazakontë</b> “. Ftohen nxënësit të tregojnë se ç’kuptojnë me këto fjalë. - Nga vëzhgimi që sapo bëmë i “Kalendarit të motit”, a ka pasur gjatë këtyre ditëve mot të pazakontë? Si do të ishte një mot i pazakontë? <i>Hetim:</i> Punohen së bashku figurat e fq.12 të librit. Përshkruhet secila figurë, tregohet lloji i motit që prezantohet dhe diskutohet se si duhet të veprojnë njerëzit për t’u mbrojtur prej tij. Nxënësit individualisht plotësojnë <i>Fletën e punës 1.4</i> , më pas në dyshe ia prezantojnë njëri-tjetrit. Paraqitet materiali/informacioni i marrë në website <a href="http://www.weatherwizkids.com">www.weatherwizkids.com</a> rreth llojeve të ndryshme të motit, ose pamje të ndryshme nga librat. Pas prezantimit diskutohet rreth llojeve të motit, mënyrat se si duhet të veprojnë njerëzit për t’u mbrojtur. Si është realizuar marrja e këtij informacioni? Në grupe me nga katër nxënës, jepet detyra e ndërtimit të një posteri. Në poster do të tregohet se si do të visheni, se si do të mbroheni nga një mot: i ftohtë e me borë; me shumë shi; i nxehtë. Prezantimi në poster do të jetë me vizatime dhe me shkrime. <i>Lojë:</i> Secilit grup i caktohet në mënyrë të rastësishme një lloj moti. Pjesëtarët e grupit përgatitin prezantimin e motit pa folur dhe pa shkruar, vetëm me veprime. Grupet e tjera do të gjejnë llojin e motit që tregoi grupi.	
<b>Vlerësimi:</b> Për komunikimin me të tjerët të ideve të tyre rreth motit; për vëzhgimin, regjistrimin dhe vlerësimin e kushteve të motit. Për prezantimin në forma të ndryshme të tij, duke përdorur fjalorin që përshtatet me këtë temë. Nxënësit mund të vlerësojnë posterat e njëri-tjetrit. Ata duhet të japin të paktën dy vlerësime pozitive dhe më pas një sugjerim për mënyrën se si mund të përmirësohet posteri.	
<b>Detyra:</b> Punimi i fq. 13 <i>Fletore pune</i> - Nxënësit me arritje të larta mund të bëjnë kërkime më të përparuara për veprimtarinë e kryer dhe të plotësojnë në vazhdim posterin e grupit.	<b>Refleksion:</b> trego llojin e motit që të pëlqen më shumë.
<b>Shënim:</b>	

## Ora 6

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 2	Data
<b>Tema mësimore:</b> Kontrolloni përparimin tuaj (ora 1)		<b>Situata e të nxënësve:</b> Unë di...	
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës:</b> - Identifikon ngjashmëritë dhe ndryshimet midis mjediseve të ndryshme lokale. - Tregon disa mënyra me anë të të cilave mjediset lokale ndikojnë te bimët dhe kafshët që jetojnë aty. - Diskuton për karakteristikat e motit mbështetur në vëzhgime. - Ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përfuara nga vëzhgimet individuale;			

<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b> - Rishikon përmbajtjen e të gjithë mësimeve dhe veprimtarive të punuara.</p>	<p><b>Fjalë kyçe:</b> mat, krijesa të vogla, kërkoj, regjistroj, flak , ujëra të zeza, mbroj, temperaturë, erë, shi , mot, me diell, me re, ngrohtë, ftohtë, me ngrica, dëborë, breshër, ekstrem , parashikues i motit, stuhi</p>
<p><b>Burimet:</b> enciklopedi <b>Mjete:</b> tabak letre, lapsa, ngjyra</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Shkencat sociale (Gjeografi)</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <i>Parashikim me terma paraprakë:</i> Ftohen nxënësit të shohin fjalët e reja të afishuara në faqen e murit. (Nëse nuk është plotësuar një fjalor i tillë gjatë orëve të mëparshme, mësuesja shkruan në tabelë fjalët: <b>mat, krijesa të vogla, kërkoj, regjistroj, flak , ujëra të zeza, mbroj, temperaturë, erë, shi , mot, me diell, me re, ngrohtë, ftohtë, me ngrica, dëborë, breshër, ekstrem, parashikues i motit, stuhi</b>). Më pas u jepet detyrë që, duke përdorur të paktën 4 prej këtyre fjalëve, të tregojnë çfarë mbajnë mend nga mësimeve të mëparshme. Pas përgjigjeve të disa nxënësve, ftohen të punojnë individualisht në plotësimin e fq. 14 dhe 15 të librit. Në fund, u jepet kohë që të diskutojnë në dyshe gjetjet me njëri-tjetrin. <i>Diskutim:</i> Më pas diskutohen me gjithë klasën përgjigjet e ushtrimit 2 b, ushtrimit 3 dhe ushtrimit 4 c. Gjatë diskutimit, kërkohet dhe argumentimi i përgjigjeve duke përdorur fjalorin përkatës.</p>	
<p><b>Vlerësimi:</b> Për prezantimin e saktë dhe në forma të ndryshme të mendimeve, duke përdorur fjalorin e përshtatshëm; për komunikimin e ideve të tyre me të tjerët.</p>	
<p><b>Detyra:</b> Trego me shkrim ose me vizatim një mbresë nga këto grup mësimesh.</p>	<p>Refleksion:</p>
<p><b>Shënim:</b> Nxënësit gjatë orës mësimore, për argument të mendimeve, mund të përdorin dhe shembuj nga enciklopeditë.</p>	

## Ora 7

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 2	Data
<p><b>Tema mësimore:</b> Kontrolloni përparimin tuaj (ora 2)</p>		<p><b>Situata e të nxënit:</b> Unë di...</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b> - Identifikon ngjashmëritë dhe ndryshimet midis mjediseve të ndryshme lokale. - Tregon disa mënyra me anë të të cilave mjediset lokale ndikojnë te bimët dhe kafshët që jetojnë aty. - Diskuton për karakteristikat e motit, mbështetur në vëzhgime. - Ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përfutuara nga vëzhgimet individuale.</p>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b> - Rishikon përmbajtjen e të gjitha mësimeve dhe veprimtarive të punuara. - Prezanton me forma të ndryshme njohuritë e marra dhe aftësitë e qëndrimet e fituara.</p>	<p><b>Fjalë kyçe:</b> mjedis, bimë, kafshë, kujdes ndaj mjedisit, moti</p>		

<b>Burimet:</b> enciklopedi <b>Mjete:</b> tabak letre, lapsa, ngjyra	<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Shkencat sociale (Gjeografi); Gjuhët (Gjuhë Shqipe); Art (Art pamor)
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <i>Projekt:</i> Nxënësit prezantojnë mbresat e tyre, të punuara në detyrat e shtëpisë. Ndahen në grupe dhe secilit grup i jepet për detyrë të punojë e prezantojë nga një poster me tema: “Mjediset dhe ndikimi te bimët dhe kafshët”; “Mënyra të ndryshme të përmirësimit të mjedisit përreth”; “Llojet e motit, veshjet dhe stinët të cilës i përkasin”. Udhëzohen nxënësit në grupe në ndarjen e detyrave brenda grupit dhe mbështeten gjatë punës së tyre. <i>Prezantim:</i> Të gjitha grupet, me të njëjtën kohë në dispozicion, prezantojnë posterat dhe përshkruajnë atë duke përdorur fjalorin e duhur.	
<b>Vlerësimi:</b> Për prezantimin e saktë dhe në forma të ndryshme të mendimeve, duke përdorur fjalorin e përshtatshëm; për komunikimin dhe bashkëpunimin me të tjerët.	
<b>Detyra:</b>	<b>Refleksion:</b>
<b>Shënim:</b> Të njëjtën temë të punës së grupit mund ta kenë njëkohësisht disa grupe.	



## Kapitulli 2: Shkëmbinjtë

### Ora 8

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 2	Data
<b>Tema mësimore:</b> Çfarë janë shkëmbinjtë?		<b>Situata e të nxëniet:</b> Krahasojmë shkëmbinjtë	
<p><b>Rezultatet e të nxëniet sipas kompetencave të fushës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vëzhgon llojet e ndryshme të shkëmbinjve dhe të dherave.</li> <li>- Identifikon llojet e ndryshme të shkëmbinjve dhe të dherave.</li> <li>- Tregon kuriozitet për vetitë dhe përdorimet e materialeve, shkëmbinjve dhe dherave të ndryshme.</li> </ul>			
<p><b>Rezultatet e të nxëniet sipas temës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njihet me disa lloje shkëmbinjsh.</li> <li>- Përdor përvojën e drejtpërdrejtë në hetim.</li> <li>- Kryen dhe regjistron vëzhgime.</li> <li>- Përdor një shumëllojshmëri mënyrash për t'u treguar të tjerëve çfarë ka ndodhur.</li> <li>- Bën krahasime të parashikimeve me vëzhgimet e regjistruara.</li> <li>- Identifikon grupe dhe struktura të thjeshta.</li> </ul>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> shkëmb, gur gëlqeror, gur shkëmbor, gurore, granit, mbledh, gur ranor</p>	
<p><b>Burimet:</b> enciklopedi, website <a href="http://www.roksforkids.com/RFK/howrocks.html">www.roksforkids.com/RFK/howrocks.html</a></p> <p><b>Mjete:</b> lupë dore, mostra të ndryshme shkëmbinjsh, një mjet të fortë, lapsa, lapustilë, një enë e tejudkshme plastike si mjet të thjeshtë për matjen e vëllimit, peceta letre, orë ose kronometër</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Shkencat sociale (Gjeografi) Gjuhët (Gjuhë Shqipe)</p>	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <i>Diskutim për njohuritë paraprake:</i> U paraqiten nxënësve 2 lloje gurësh dhe u bëhen pyetjet: Çfarë janë këta? Ku i keni parë? Kërkohej nga nxënësit që të diskutojnë çfarë shohin në figurat e fq. 17 të librit. Prezantohen lloje të ndryshme shkëmbinjsh ose mund të përdorë materialet nga website: <a href="http://www.roksforkids.com/RFK/howrocks.html">www.roksforkids.com/RFK/howrocks.html</a>, i cili paraqet lloje të ndryshme shkëmbinjsh. Nxënësve u jepet, ose shkruhet në posterin fjalor të klasës, fjalori që lidhet me shkëmbinjtë. <i>Hetimi:</i> Ndahen nxënësit në grupe. Prezantohet veprimtaria e parë mbi krahasimin e shkëmbinjve. Nxënësit do të përpiqen që t'i përgjigjen pyetjes: “<i>Cilat janë ndryshimet midis këtyre shkëmbinjve?</i>” Ata duhet të mbledhin prova duke vëzhguar me kujdes çdo shkëmb. Të krahasojnë shkëmbinjtë dhe të vënë re çdo ndryshim; për shembull, ngjyrën, nëse kanë kokrriza apo vrima të dukshme, nëse kanë ndonjë strukturë të caktuar, e kështu me radhë. Nxënësit mund t'i regjistrojnë vëzhgimet e tyre nëpërmjet <i>Fletëve të punës 2.1a</i> dhe <i>2.1b</i>. (<i>Fleta e punës 2.1a</i> do të ndihmojë nxënësit me arritje më të ulëta, ndërsa <i>Fleta e punës 2.1b</i>, nxënësit me arritje më të larta). Prezantohen punimet nga disa prej nxënësve.</p>			

Prezantohet veprimtaria e dytë mbi vëzhgimin e vetive të shkëmbinjve. Nxënësit duhet të fillojnë pjesën e parë të hetimit duke parashikuar se cili nga shkëmbinjtë do të jetë më i fortë se të tjerët. Emërtohen copat e shkëmbinjve A, B, C për t'u identifikuar. Nxënësit duhet të regjistrojnë parashikimin e tyre në *Fletën e punës 2.1c*. Më pas, nxënësit do të marrin një gozhdë në dorë dhe të gërvishtin me të çdo shkëmb sipas radhës. Ata duhet të vëzhgojnë se çfarë ndodh për çdo rast. Duhet të krahasojnë shkëmbinjtë dhe të thonë se cili prej tyre është shkëmbi më i fortë. Pjesa e dytë e hetimit ka të bëjë me faktin se cili nga shkëmbinjtë do të mbajë më shumë ujë. Përsëri, nxënësit duhet të bëjnë një parashikim përpara se të fillojnë krahasimin. Do të ishte e dobishme nëse nxënësit do të vëzhgonin shkëmbinjtë me kujdes duke përdorur një lupë. A mund të shohin ata ndonjë ndryshim midis shkëmbinjve që gërvishteshin më lehtë me gozhdë dhe shkëmbinjve që gërvishteshin më me vështirësi? (Shkëmbinjtë më të fortë me shumë gjasa do të kenë më pak 'vrime' të dukshme në sipërfaqen e tyre.)

Kërkoni nga nxënësit që të hedhin pak ujë në enën vëllim-matëse (ena nuk duhet të mbushet deri në grykë, pasi niveli i ujit do të ngrihet kur nxënësit të vendosin copën e shkëmbit brenda në enë) dhe të shënojnë nivelin e ujit në enë. Më pas, duhet të futin brenda enës copën e parë të shkëmbit dhe ta lënë atë atje për 3 minuta. Pas 3 minutash, nxënësit duhet ta nxjerrin copën e shkëmbit jashtë enës. Kërkoni që copa e shkëmbit të nxirret me kujdes nga ena, në mënyrë që të mos ndodhë derdhja e ujit jashtë enës. Më pas, ata duhet ta thajnë copën e shkëmbit me një pecetë letre. Nxënësit do të kontrollojnë vëllimin e mbetur të ujit në enë. Nëse copa e shkëmbit ka thithur ujë, atëherë vëllimi i mbetur në enë do të jetë më i vogël se vëllimi fillestar. Nxënësit duhet të shënojnë nivelin e ri të ujit në enë dhe ta emërtojnë 'Shkëmbi A'.

Pasi nxënësit të rimbushin enën me ujë deri në nivelin fillestar, hetimi duhet të përsëritet për copën tjetër të shkëmbit, e kështu me radhë. Në fund të hetimit, shenja më e ulët në enë do të tregojë llojin e shkëmbit që ka thithur më shumë ujë. Nxënësit duhet të krahasojnë rezultatet e tyre dhe të regjistrojnë se cili shkëmb përthith më shumë ujë.

Në përfundim, kërkoni nga nxënësit nëse mund të identifikojnë ndonjë element lidhës në rezultatet e tyre. Fortësia e shkëmbinjve lidhet shpesh me porozitetin e tyre, kështu që nxënësit duhet të vënë re që shkëmbinjtë më të butë priren që të përthithin më shumë ujë. Nxënësit me arritje më të larta mund të nxiten gjithashtu që të përmendin detaje të tjera shtesë për faktin pse hetimi në *Fletën e punës 2.1c* nuk është një provë e rregullt.

*Përfundimet e hetimit:* Së bashku me nxënësit i rikthehemi pyetjes së kërkimit: 'Cilat janë ndryshimet midis këtyre shkëmbinjve? Dhe nëpërmjet përgjigjeve të nxënësve, përmblihen përfundimet e dala nga vëzhgimet.

**Vlerësimi:** Për dallimin e llojeve të ndryshme të shkëmbinjve. Nxënësit mund të vlerësojnë punën e tyre gjatë veprimtarive: Çfarë kam mësuar gjatë kryerjes së vëzhgimeve?

**Detyra:** Punimi fq. 14, në *Fletoren e punës*

**Refleksion:** Çfarë bën mirë?  
Ku patën vështirësi?

**Shënim:** Në veprimtarinë e dytë përdoren mjete dhe matje shumë të thjeshta, kështu që prova nuk është fort e rregullt. Megjithatë, ajo jep një ide rreth faktit se sa ujë përthithin shkëmbinjtë, nëse mund të ketë të tillë. Mund të fillohet një diskutim mbi faktin nëse prova ishte e rregullt. Një problem i dukshëm është që copat e shkëmbinjve ka pak mundësi që të kenë të njëjtën madhësi. Kështu që sasia e ujit të përthithur do të varet si nga madhësia e copave, ashtu edhe nga shkalla e tyre e porozitetit. Për më tepër, disa nxënës mund të mos jenë fort të saktë në shënimin e niveleve të ujit në enë ose gjatë rimbushjes së enës deri në nivelin fillestar. -Disa nxënës mendojnë se disa materiale të prodhuara nga dora e njeriut, siç është betoni, janë shkëmbinj. Të gjithë shkëmbinjtë janë materiale natyrore, por jo të gjitha materialet e forta që përdoren në ndërtim janë materiale natyrore.

**Ora 9**

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 2	Data
<b>Tema mësimore:</b> Përdorimi i shkëmbinjve		<b>Situata e të nxënit:</b> Përdorimi i materialeve shkëmbore.	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vëzhgon llojet e ndryshme të shkëmbinjve dhe të dherave.</li> <li>- Identifikon llojet e ndryshme të shkëmbinjve dhe të dherave.</li> <li>- Përshkruan përdorimet e shkëmbinjve të ndryshëm.</li> <li>- Tregon kuriozitet për vetitë dhe përdorimet e materialeve, shkëmbinjve dhe dherave të ndryshme.</li> </ul>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njeh përdorimet e shkëmbinjve të ndryshëm.</li> <li>- Përdor përvojën e drejtpërdrejtë në hetim.</li> <li>- Kryen dhe regjistron vëzhgimet.</li> <li>- Përdor një shumëllojshmëri mënyrash për t'u treguar të tjerëve atë që ka ndodhur.</li> </ul>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> diamant, kuarc, gur me shtresa, mermer</p>	
<p><b>Burimet:</b> enciklopedi, ilustrime, website</p> <p><b>Mjete:</b> lupë dore, lapsa, fletë pune</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Shkencat sociale (Gjeografi)</p>	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <p><i>Përmbledhje e strukturuar:</i> Prezantohet tema duke treguar pamje të ambienteve ku jetojmë. Në to do të tregohet përdorimi i disa materialeve shkëmbore, por edhe i materialeve të tjera që mund të përdoren në shtëpi, për të treguar shembuj të shkëmbinjve të ndryshëm. Sqarohet se disa artikuj që nxënësit mund të mendojnë se janë materiale shkëmbore, të tillë si muret, lavamani dhe enët e porcelanit, ngjasojnë me materialet shkëmbore, por nuk janë vërtet shkëmbinj; për shembull, porcelani zakonisht prodhohet nga qeramika. Diskutohen së bashku figurat në fq. 18 të librit.</p> <p><i>Përmbledhja pohim mbështetje:</i> Prezantohet te nxënësit pohimi: “Gurët shkëmborë kanë përdorime të ndryshme” dhe ftohen nxënësit të organizuar në dyshe të vështrojnë përreth shkollës dhe në rrethinat e saj për praninë e materialeve të ndryshme shkëmbore. Nxënësit do të vështrojnë për materiale shkëmbore në ndërtesa, mure, çati dhe rrugë. Udhëzohen për të bërë dallimin midis materialeve shkëmbore natyrore dhe materialeve të prodhuara nga dora e njeriut, të tilla si: beton, llaç apo asfaltobeton. Theksohet që shumë materiale ndërtimore, të tilla si pllakat e dyshemesë, tjegullat e çatisë, tullat, betoni dhe plastikat e ndryshme nuk janë materiale natyrore, por të prodhuara nga dora e njeriut. Gjithashtu në përbërjen e dheut ka materiale shkëmbore. Kjo përfshin padyshim gurët, por edhe grimcat më të vogla të rërës. Nxënësit mund të krahasojnë materialet shkëmborë që gjejnë dhe të përshkruajnë karakteristikat e disave prej tyre, të tilla si, ngjyra, struktura dhe forma, duke i prekur me dorë dhe duke i vështruar me kujdes me një lupë dore. Nxiten nxënësit të japin mendime rreth faktit pse materialet shkëmbore të vëzhguara prej tyre janë përdorur për një qëllim të caktuar. Cilat veti të materialeve shkëmbore janë të rëndësishme? Nxënësit mund të bëjnë vizatime të shkëmbinjve, përfshirë ngjyrën e tyre ose të shkruajnë çfarë kanë zbuluar në <i>Fletën e punës 2.2a</i>. Nxënësit me arritje më të larta mund të nxiten gjithashtu që të punojnë dhe në <i>Fletën e punës 2.2c</i>.</p>			

<p>Dyshet prezantojnë gjetjet e tyre, ndërkohë që së bashku ndërtohet një librari ose muzeum i materialeve shkëmbore. Kjo mund të përfshijë copa të materialeve shkëmbore, vizatime të materialeve shkëmbore që ndeshen në ndërtesat përreth. Muzeumi mund të jetë pjesë e fletës murale të prezantimit të këtij mësimi/kapitulli.</p>	
<p><b>Vlerësimi:</b> A mund të diskutojnë nxënësit pse disa materiale shkëmbore përdoren për qëllime të ndryshme? Gjatë shëritjes në mjediset e shkollës dhe përreth saj, a mund t'i dallojnë materialet shkëmbore dhe të thonë për çfarë përdoret një material i caktuar shkëmbor? Çfarë kanë mësuar ata nga veprimtaria e zhvilluar?</p>	
<p><b>Detyra:</b> Punimi i fq. 15, <i>Fletore pune</i> -Punim i Fletës së punës 2.2b</p>	<p><b>Refleksion:</b> Nxënësit tregojnë: Çfarë bënë mirë? Ku e patën të vështirësinë?</p>
<p><b>Shënim:</b> Përdorim i internetit dhe TIK: Bëni fotografi dixhitale të mostrave të materialeve shkëmbore si edhe të materialeve shkëmbore të përdorur në ndërtesa dhe në shtresa të ndryshme dyshemeje. -Këto website: <a href="http://www.gly.uga.edu/railsback/BS-Main.html">www.gly.uga.edu/railsback/BS-Main.html</a> dhe <a href="http://www.sci-eng.mmu.ac.uk/manchester_stone/">www.sci-eng.mmu.ac.uk/manchester_stone/</a> paraqesin një set fotografish të ndërtesave të ndryshme dhe të materialeve shkëmbore të përdorura për ndërtimin e tyre.</p>	

## Ora 10

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 2	Data
<b>Tema mësimore:</b> Dheu		<b>Situata e të nxënit:</b> Gjejmë materiale shkëmbore në tokë.	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshtet përdorimet e shkëmbinjve të ndryshëm.</li> <li>- Zbulon praktikisht përbërësit e dheut.</li> <li>- Tregon kuriozitet për vetitë dhe përdorimet e materialeve, shkëmbinjve dhe dherave të ndryshme.</li> <li>- Vlerëson burimet e ndryshme të informacionit që mbështesin kërkimin e tij.</li> </ul>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njihet me disa lloje materialesh shkëmbore dhe përdorimet e ndryshme të tyre.</li> <li>- Mbledh prova nëpërmjet kryerjes së vëzhgimeve, ndërsa përpiqet që t'i përgjigjet një pyetjeje shkencore.</li> <li>- Përdor përvojën e drejtpërdrejtë për të mbledhur prova.</li> <li>- Kryen dhe regjistron vëzhgime.</li> <li>- Bën krahasime të materialeve shkëmbore.</li> <li>- Identifikon grupe dhe struktura të thjeshta shkëmbore.</li> <li>- Përmbledh dhe shpjegon punën e kryer.</li> </ul>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> dhe, rërë (ranor), gur, argjilë</p>	

<p><b>Burimet:</b> enciklopedi, ilustrime, website  <b>Mjete:</b> mostra të ndryshme tokash, një enë plastike me ujë, lupë dore, lapsa, fletë pune</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b>                  Shkencat sociale (Gjeografi)</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b>  <i>Vizitë në oborrin e shkollës:</i> Shoqërohet klasa në ambientet përreth shkollës për t'i hedhur një vështrim tokës (dherave) në vende të ndryshme. Në këtë veprimtari do të mblidhen prova me qëllim përgjigjen e pyetjes shkencore: “Si ndikon lloji i tokës mbi gjallesat që jetojnë në të?” Me një lopatëz, nxënësit apo mësuesi mund të gërmojnë vrima të vogla në tokë që të shohin tokën poshtë sipërfaqes së saj. Toka është shtëpia për shumë qenie të gjalla. Toka është gjithashtu vendi ku rrenjëjt e bimëve zënë vend dhe marrin përbërësit ushqimorë kryesorë. Merren në klasë lloje të ndryshme toke nga vende të ndryshme. Me ndihmën e një lupe kërkohet nga nxënësit që ta vëzhgojnë me kujdes tokën.  <i>Përmbledhje e strukturuar:</i> Diskutohet rreth asaj që shihet duke iu referuar pamjeve të fq. 20 të librit, të cilat paraqesin gjërat e ndryshme që gjenden në tokë. U shpjegohet nxënësve që toka përbëhet nga shtresa të ndryshme. Shtresa më e errët ndodhet në sipërfaqe ndërsa shtresat më të çelura në ngjyrë dhe copat e materialeve shkëmbore gjenden më në thellësi të saj. Për të ndihmuar nxënësit, përdorni figurën në faqen 21 të Librit të nxënësit si edhe website-n <a href="http://mocomi.com/soil-profile/">mocomi.com/soil-profile/</a>.  <i>Hetimi 1:</i> Në fillim të hetimit, nxënësit në dyshe do të krahasojnë llojet e ndryshme të tokave, duke i vëzhguar ato me kujdes. A mund të shohin ata ndonjë ndryshim midis tyre? Më pas, pyesni nxënësit që të vendosin mostrën e parë të tokës brenda një ene me ujë dhe më pas ta tundin enën që të mundësojnë qarkullimin e ujit dhe ndarjen e tokës në pjesët e saj përbërëse. Nxënësit vëzhgojnë dhe përshkruajnë atë çfarë ndodh. Kërkohet nga nxënësit që ta përsëritin veprimin me llojet e tjera të tokave, çdo herë duke filluar me një enë të pastër me ujë. Krahasohen rezultatet nga llojet e ndryshme të tokave duke i hedhur të dhënat në <i>Fletën e punës 2.3a</i> (më e përshtatshme për nxënësit me arritje më të ulëta) dhe <i>Fletën e punës 2.3b</i> (më e përshtatshme për nxënësit me arritje më të larta). Diskutohet me nxënësit për faktin se si ndryshojnë llojet e ndryshme të tokave?  <i>Hetimi 2:</i> Në këtë hetim, nxënësit do të mblidhin prova duke kryer vëzhgime me qëllim përgjigjen e pyetjes shkencore, ‘Cili lloj i tokës do të thahet më shpejt? Nxënësit përgatitin lloje të ndryshme dherash duke shtuar disa copa materialesh shkëmbore, rërë dhe ujë në të njëjtën sasi pleh. Nxënësit bëjnë një parashikim rreth asaj se çfarë do të ndodhë. Cili lloj i tokës do të lejojë depërtimin në të, të sasisë më të madhe të ujit? Llojet e tokës vendosen më pas mbi tabaka apo mbi fletë të trasha kartoni me vrima drenazhimi të hapura në to. Vrimat e drenazhimit duhet të hapen përpara zhvillimit të veprimtarisë – çdo tabaka duhet të ketë afërsisht të njëjtën sasi vrimash për të garantuar vlefshmërinë e testit. Nxënësit duhet të vendosin gota identike nën çdo lloj toke. U sille në vëmendje që mostrat e dherave duhet të mbahen në të njëjtin vend për të siguruar rregullsinë e provës (prova do të jetë e parregullt nëse kushtet nuk janë të njëjta për të gjitha mostrat). Nxënësit duhet të vëzhgojnë dhe të krahasojnë se sa ujë depërton në gotë për çdo mostër toke. Vëzhgimet e tyre regjistrohen në <i>Fletën e punës 2.3d</i>.  <i>Vlerësimi i rezultateve:</i> Me nxënësit diskutohet rreth parashikimeve, ata përmbledhin dhe shpjegojnë çfarë ka ndodhur: Çfarë kishte në mostrat e dheut që ndikoi në sasinë e ujit në gotë?</p> <p><b>Vlerësimi:</b> Gjatë vëzhgimit të llojeve të ndryshme të tokave, a mundën nxënësit që të komentojnë mbi llojin e grimcave të materialeve shkëmbore që vëzhguan? A mundën nxënësit që të diskutojnë, të skicojnë apo të shkruajnë rreth rëndësisë së grimcave të materialeve shkëmbore në tokë?</p>	

<p><b>Detyra:</b> Punimi i fq. 16, <i>Fletore pune</i></p> <p>-Listoni prodhime ushqimore që rriten në tokë (p. sh. gjethe sallate, perime, bimë shtëpiake) ose që vijnë nga bimët dhe kafshët të cilat nga ana e tyre varen nga toka.</p> <p>-Në dyshe do të punohet për projektin: Sa e përshtatshme është toka për zhvillimin e farave të bimëve? Punim i <i>Fletës së punës 2.3c</i></p>	<p><b>Refleksion:</b> Nxënësit tregojnë: Çfarë bënë mirë? Ku e patën të vështirësinë?</p>
<p><b>Shënim:</b> Në fund të orës së mësimit jepen udhëzimet mbi zhvillimin në dyshe të projektit si detyrë në shtëpi. Ky projekt shoqërohet me plotësimin e <i>Fletës së punës 2.3c</i>.</p> <p>Kërkoni nga nxënësit që të bëjnë sugjerime rreth mënyrës se si do të mblidhen provat në këtë hetim. Nxënësit duhet të mbjellin disa fara të të njëjtit lloj në çdo mostër të veçantë toke. Siguroni që të emërtoni mostrat e tokave. Që të jetë një krahasim i drejtë, kujtoni nxënësit se duhet të ujisin çdo mostër toke me të njëjtin sasi uji dhe të sigurojnë të njëjtën sasi drite për secilën prej tyre. Kërkoni prej tyre që të parashikojnë se cilat fara do të rriten më shpejt. Ata mund t'i regjistrojnë parashikimet e tyre në fletën e punës. Nëse do të përdoren fara me mbirje relativisht të shpejtë, siç janë fasulet ose gruri, mbirja e farave mund të pritet pas afro dy javësh. Do të duhen disa javë të tjera për të parë se çfarë do të ndodhë me rritjen e farave. Ndërsa hetimi vijon, sigurohuni që nxënësit të kujdesen për rritjen e tyre, por ndërkohë procesi mësimor duhet të vijojë me temat e tjera. Në fund të hetimit, nxënësit mund të regjistrojnë në fletën e punës llojin e tokës më të përshtatshme për rritjen e farave. Kërkojuni atyre që të diskutojnë për atë ka ndodhur, si edhe të diskutojnë parashikimet dhe rezultatet e tyre. A mund të tregojnë nxënësit pse një lloj i caktuar toke është më i përshtatshëm se të tjerat për rritjen e bimëve?</p> <p>Prezantimi i projekteve mund të bëhet në një minutazh të caktuar gjatë orës “Kontrolloni përparimin tuaj” dhe në vazhdim.</p>	

## Ora 11

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 2	Data
<p><b>Tema mësimore:</b> Materiale të tjera natyrore</p>		<p><b>Situata e të nxënit:</b> Gjetja e materialeve</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Identifikon materiale të përbëra nga lëndë natyrore dhe ato të prodhuara nga njeriu.</li> <li>- Klasifikon materiale të përbëra nga lëndë natyrore dhe ato të prodhuara nga njeriu.</li> <li>- Përshkruan përdorimet e shkëmbinjve të ndryshëm.</li> <li>- Vlerëson burimet e ndryshme të informacionit që mbështesin kërkimin e tij.</li> </ul>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mëson që disa materiale janë natyrore dhe disa të tjera të prodhuara nga dora e njeriut.</li> <li>- Përdor përvojën e drejtpërdrejtë në gjetjen e llojeve të materialeve.</li> <li>- Kryen dhe regjistron vëzhgime.</li> <li>- Identifikon grupe dhe struktura të thjeshta.</li> </ul>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> natyror, i prodhuar nga njeriu</p>	



<p><b>Burimet:</b> enciklopedi, ilustrime, ambienti përreth <b>Mjete:</b> lapsa, fletë pune</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Arte (Teknologji)</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <i>Diskutim për njohuritë paraprake:</i> Prezantohet figura e fq. 22 të librit. Diskutohet rreth materialeve që shihen në figurë. Ftohen të japin mendimin e tyre se cilat materiale janë natyrore dhe cilat materiale të prodhuara nga dora e njeriut. Prezantohen disa materiale të prodhuara nga dora e njeriut, si dhe përcaktohet materiali natyror prej nga janë prodhuar ato. <i>Hetim1:</i> Shoqëroni nxënësit për një shëtitje në mjediset përreth shkollës me qëllim që të vëzhgojnë shumëllojshmërinë e materialeve natyrore dhe të materialeve të prodhuara nga dora e njeriut. Nxënësit do të regjistrojnë vëzhgimet e tyre në <i>Fletën e punës 2.4a</i> dhe <i>Fletën e punës 2.4b</i> (për nxënësit me arritje me të larta). Në grupe të vogla nxënësit diskutojnë për gjetjet. Më pas nxitet diskutimi nëse ato materiale janë natyrore ose të prodhuara nga dora e njeriut. <i>Hetim2:</i> Brenda klasës nxënësit mund të identifikojnë materiale të prodhuara nga dora e njeriut, si dhe të përcaktojnë materialin natyror prej nga janë prodhuar ato. Ndërtimi i fletës murale me vizatime, gjurmë të fiksuara në letër. Iu ofrohen nxënësve materiale, libra dhe revista, ku mund të gjejnë pamje të materialeve natyrore. Kjo fletë murale do të vazhdojë të plotësohet nga nxënësit me koleksion me mostra të ndryshme të emërtuara të materialeve natyrore në ditët në vazhdim.</p>	
<p><b>Vlerësimi:</b> A mund të thonë nxënësit që disa materiale ndodhen në gjendje natyrore dhe disa të tjerë janë prodhuar nga dora e njeriut? Nëse atyre u tregohen disa lloje materialelesh, a mund të identifikojnë nxënësit në to disa prej materialeve natyrore? A mund t'i grupojnë nxënësit materialet natyrore? A mund ta bëjnë këtë gjë duke u nisur vetëm nga emrat e materialeve?</p>	
<p><b>Detyra:</b> Punimi i fq. 17, <i>Fletore pune</i> - “Gjuetia e materialeve natyrore në shtëpi” duke listuar ato materiale që gjejnë.</p>	<p><b>Refleksion:</b> Nxënësit tregojnë: Çfarë shkoi mirë? Ku ndeshën ata vështirësi? Çfarë mësuan nga veprimtaria?</p>
<p><b>Shënim:</b> Tregoni kujdes për të dalluar midis objekteve dhe materialeve prej të cilave prodhohen. Bisedoni për faktin se nga vijnë materialet natyrore – për shembull, druri vjen nga pemët – dhe nga se janë ndërtuar materialet e prodhuara nga dora e njeriut. Filloni me shembujt lehtësisht të kuptueshëm të materialeve natyrore të tilla si: guaskat, rëra, kashta, shkëmbinjte, gjethet, patatet dhe uji. Pambuku është material natyror, por pambuku i fabrikës është material i prodhuar nga dora e njeriut, e njëjta gjë mund të thuhet për letrën (ky argument është përmendur më përpara). Shembuj të tjerë që mund të gjeni janë pëlhurat prej pambuku, toka, qumështi dhe çokollata, frutat e ndryshme në çantë, hekuri dhe anija. Shembuj të materialeve të prodhuara nga dora e njeriut janë: plastikat, hekuri, çeliku, boja dhe pasta e dhëmbëve. Mund të përmenden edhe shembuj më intrigues si produktet e prodhuara në fabrikë, qelqi dhe najloni, për shembull. Mos u shqetësoni nëse nxënësit i konsiderojnë rastet më të vështira si të drejta apo të gabuara. Kryesore është cilësia e diskutimit. Mund të mos jeni të sigurt për materialet me të cilat janë ndërtuar objektet e ndryshme. Kjo nuk përbën problem – madje lejoni që të tregohet në mënyrë pozitive se procesi i të mësuarit nuk mbaron kurrë. Brenda dhe jashtë shkollës mund të gjendet një shumëllojshmëri e materialeve të përdorura.</p>	

## Ora 12

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 2	Data
<b>Tema mësimore:</b> Kontrolloni përparimin		<b>Situata e të nxënit:</b> unë di...	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Identifikon llojet e ndryshme të shkëmbinjve dhe të dherave.</li> <li>- Përshkruan përdorimet e shkëmbinjve të ndryshëm.</li> <li>- Identifikon materiale të përbëra nga lëndë natyrore dhe ato të prodhuara nga njeriu.</li> <li>- Klasifikon materiale të përbëra nga lëndë natyrore dhe ato të prodhuara nga njeriu.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b>		<b>Fjalë kyçe:</b> shkëmb, material natyror	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rishikon përmbajtjen e të gjitha mësimëve dhe të veprimtarive të punuara.</li> </ul>			
<b>Burimet:</b> enciklopedi, muralja e klasës		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b>	
<b>Mjete:</b> tabak letre, lapsa, ngjyra, vazot me farat e bimëve të mbjella në to.		Shkencat sociale (Gjeografi), Arte (Teknologji), Shkencat (Biologji)	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b>			
<i>Prezantimi i murales së plotësuar gjatë ditëve në lidhje me materialet dhe përforcimit të tyre.</i>			
Ftohen nxënësit të punojnë individualisht në plotësimin e fq. 24 dhe 25 të librit. Përfundimet diskutohen me gjithë klasën			
<i>Prezantimi i projektit:</i> Sa e përshtatshme është toka për zhvillimin e farave të bimëve. Nxënësit në grupe prezantojnë rezultatet e vëzhgimeve dhe argumentojnë përfundimet duke u orientuar në <i>Fletën e punës 2.3c</i>			
<b>Vlerësimi:</b> Për shkallën e përvetësimit të njohurive/shkathtësive dhe qëndrimeve gjatë këtyre mësimëve; për prezantimin e saktë dhe në forma të ndryshme të mendimeve duke përdorur fjalorin e përshtatshëm; për komunikimin e ideve të tyre te të tjerët.			
<b>Detyra:</b> Vizato një gjë të re që mësove gjatë këtyre grup mësimësh.		<b>Refleksion:</b>	
<b>Shënim:</b> Nxënësit gjatë orës mësimore, për argument të mendimeve mund të përdorin dhe shembuj nga enciklopeditë.			



## Kapitulli 3: Ndryshimi i materialeve

### Ora 13

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 2	Data
<b>Tema mësimore:</b> Ndryshimi i formës së materialeve		<b>Situata e të nxënit:</b> Ngjeshja	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës :</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkruan ndryshimet që ndodhin te materialet, si rezultat i përkuljes, përdredhjes, zgjatje, ngjeshjes.</li> </ul>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mëson se si forma e disa materialeve ndryshon gjatë ushtrimit mbi to të një force shtypëse.</li> <li>- Përdor përvojën e drejtpërdrejtë gjatë mbledhjes së provave.</li> <li>- Parashikon se çfarë do të ndodhë përpara se të vendosë se çfarë do të bëjë.</li> <li>- Kryen dhe regjistron vëzhgime.</li> <li>- Mbledh prova nëpërmjet kryerjes së vëzhgimeve, bërjes së krahasimeve ndërsa përpiqet që t'i përgjigjet një pyetjeje shkencore.</li> </ul>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> përkul, përdredh, tërheq, ngjesh, ndryshoj formë.</p>	
<p><b>Burimet:</b> enciklopedi, ilustrime</p> <p>Mjete: plastelinë, sfungjer, dru, plastikë, sapun, shkumës, lapsa, fletë pune</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Arte (Teknologji) Shkencë (Fizikë)</p>	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <p><i>Brainstorming:</i> Duke treguar plastelinën shtrohet pyetja para nxënësve: Çfarë mund të bëjmë me të? Ftohën nxënësit të tregojnë duke demonstruar.</p> <p>Prezantohen fjalët kyçe: përkul, përdredh, tërheq, ngjesh, ndryshoj, formë. Diskutohet kuptimi i tyre së bashku me nxënësit (mund të përdoren për mbështetje të konkretizimit dhe figurat e fq. 26 të Librit)</p> <p><i>Lojë:</i> Nxënësit në dyshe do të krijojnë me radhë forma të ndryshme me plastelinë. Gjatë krijimit të formave nxënësit i shoqërojnë veprimet duke përdorur dhe shpjegimet me fjalë.</p> <p>Udhëzohen të kenë parasysh përdorimin e fjalëve: përkul, përdredh, tërheq, ngjesh, ndryshoj formë.</p> <p><i>Hetimi:</i> Pasi sigurohemi që të gjithë dyshet kanë të paktën nga një material që ngjishet me lehtësi (p.sh. sfungjeri), një material që ngjishet me vështirësi (p.sh. goma) si dhe një material që nuk mund ngjishet me dorë (p.sh. shkumësi). U kërkohet nxënësve që të ndjekin udhëzimet e fq. 27 të librit. Bisedohet me ta se në fushën e shkencës kërkohet formulimi i një pyetjeje si edhe është e nevojshme që të bëhen parashikime. (Një pyetje e përshtatshme mund të jetë: “Si ndryshojnë materialet kur i nënshtrohen shtypjes?”).</p> <p>Nxënësit duhet të parashikojnë se çfarë do të ndodhë me secilin material, përpara se materiali t'i nënshtrohet shtypjes. Ata duhet të përshkruajnë pamjen e materialit përpara ushtrimit të shtypjes mbi të.</p>			

<p>Nxënësit mund të mbledhin prova duke u përpjekur që të shtypin secilin material duke përdorur një gisht të dorës. Për të regjistruar dhe krahasuar vëzhgimet e materialeve përpara dhe pas shtypjes nxënësit do të përdorin <i>Fletët e punës 3.1a</i> dhe <i>3.1b</i>. <b>Përfundime:</b> Diskutohet rreth faktit se si ndryshon forma e çdo materiali. A kthehet materiali në gjendjen fillestare kur nxënësit largojnë gishtin nga materiali? U kërkohet nxënësve që të bëjnë krahasime midis materialeve. Nxënësit duhet të tregojnë se çfarë ndodhi dhe nëse parashikimi i bërë prej tyre ishte i saktë.</p>	
<p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen për përshkrimin që bëjnë se si mund të ndryshohet forma e materialeve nëpërmjet shtypjes, përkuljes, përdredhjes dhe/ose tërheqjes. Nxënësit vetë-vlerësojnë punën e tyre duke komentuar çfarë bënë mirë dhe çfarë do të donin që të përmirësonin.</p>	
<p><b>Detyra:</b> Punimi i fq. 18, <i>Fletore Pune</i> - Nxënësve u kërkohet që të vështronjë përreth shtëpisë dhe të regjistrojnë materiale të cilat ndryshojnë formë kur i nënshtrohen shtypjes.</p>	<p><b>Refleksion:</b> Tregoni një material me të cilin u pëlqen të luani dhe thoni pse.</p>
<p><b>Shënim:</b> Nxënësit me arritje më të larta do të përfitojnë më shumë nëse atyre u jepet një shumëllojshmëri më e gjerë shembujsh. Nga ata pritet që të përdorin fjalorin e duhur për sa u përket materialeve dhe hetimit. Prisi nga nxënësit që të punojnë në mënyrë më të pavarur. P.sh. jepuni atyre njëfarë pavarësie në zgjedhjen e materialeve me qëllim që të planifikojnë vetë hetimin.</p>	

## Ora 14

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 2	Data
<b>Tema mësimore:</b> Përkulja dhe përdredhja		<b>Situata e të nxënësve:</b> Luajmë me brumë	
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës :</b> - Përshkruan ndryshimet që ndodhin te materialet, si rezultat i përkuljes, përdredhjes, zgjatje, ngjeshjes.			
<b>Rezultatet e të nxënësve sipas temës:</b> - Mëson faktin se si format e disa materialeve mund të ndryshohen nëpërmjet përkuljes dhe përdredhjes. - Përdor përvojën e drejtpërdrejtë për të zbuluar faktet. - Kryen dhe regjistrojnë vëzhgime.		<b>Fjalë kyçe:</b> përkul, përdredh, brumë	
<b>Burimet:</b> enciklopedi, ilustrime <b>Mjete:</b> brumë ose plastelinë, lapsa, fletë pune		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Arte (Teknologji)	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Për pak minuta diskutohet përfundimi i ushtrimit 2 të Fletës së punës. <i>Diskutim për njohuritë paraprake:</i> A mund të përdridhet tullumbacja? Po metali apo qelqi? Prezantohet mësimi dhe nxënësit tregojnë për figurat e paraqitura në fq. 28 dhe 29 të librit. Ata do të nxiten të japin mendime rreth: Si mund të ndryshohet forma e materialeve nëpërmjet përkuljes dhe përdredhjes? Në çfarë kushtesh mund të arrihet përkulja ose përdredhja e tyre? Po tullumbacet?			

<p><i>Lojë:</i> Çdo nxënësi i jepet një copë e vogël brumë ose plastelinë, në mënyrë që të kryejë vetë veprime përkulëse dhe përdredhëse në forma të ndryshme. Gjatë zhvillimit të lojës nxënësit plotësojnë dhe <i>Fletët e punës 3.2a</i> dhe <i>3.2b</i>.</p> <p>Ushtrimet në fletët e punës kërkojnë nga nxënësit që të studiojnë pamjet e materialeve që kanë përkulur dhe përdredhur e të tregojnë se si është ndryshuar forma e tyre. Diskutimi i këtyre ushtrimeve nëpërmjet prezantimit të formave të punuara do të vlejë dhe si përfundim i lojës. Tregohet kujdes në përdorimin e fjalorit të duhur në lidhje me materialet dhe hetimin e kryer mbi to.</p>	
<p><b>Vlerësimi:</b> A mund të përshkruajnë nxënësit se si mund të ndryshojnë format e disa materialeve nëpërmjet përkuljes dhe përdredhjes? Nxënësit vetëvlerësojnë punën e tyre duke komentuar çfarë bënë mirë dhe çfarë do të donin që të përmirësonin.</p>	
<p><b>Detyra:</b> Punimi i fq. 19, <i>Fletore Pune</i></p>	<p><b>Refleksion:</b> Tregoni si u ndjetë gjatë lojës.</p>
<p><b>Shënim:</b></p>	

## Ora 15

<b>Fusha:</b> Shkencë	<b>Lënda:</b> Dituri Natyre	<b>Klasa 2</b>	<b>Data</b>
<b>Tema mësimore:</b> Materialet elastike		Situata e të nxënët: Tërheqja e llastikut	
<p><b>Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave të fushës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkruan ndryshimet që ndodhin te materialet, si rezultat i përkuljes, përdredhjes, zgjatje, ngjeshjes.</li> </ul>			
<p><b>Rezultatet e të nxënët sipas temës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mëson se si format e disa materialeve mund të ndryshohen nëpërmjet tërheqjes.</li> <li>- Mbledh prova nëpërmjet kryerjes së vëzhgimeve ndërsa përpiqet që t'i përgjigjet një pyetjeje shkencore.</li> <li>- Përdor përvojën e drejtpërdrejtë dhe bën matje të thjeshta.</li> <li>- Formulon pyetje dhe sugjeron mënyra përgjigjeje për to.</li> <li>- Diskuton rreth rreziqeve dhe mënyrave të shmangies së tyre.</li> <li>- Mëson që një test apo krahasim mund të mos jetë i drejtë.</li> <li>- Kryhen dhe regjistron vëzhgime gjatë testit.</li> </ul>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> elastik</p>	
<p><b>Burimet:</b> enciklopedi, ilustrime Mjete: fije elastike të madhësive të ndryshme, një shufër mbajtëse, çantë të vogël, gurë të vegjël, spango, kapëse letrash, shirit ngjitës. sende për të matur gjatësinë, letër, pëlhura të ndryshme, një sustë stilolapsi, kub prej druri</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Arte (Teknologji) Shkencë (Fizikë)</p>	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <i>Situatë:</i> Nxënësve u tregohet një lodër fëmijësh që vihet në lëvizje nga një fije elastike (p.sh. lodër JO-JO). U drejtohen pyetje të tilla nxënësve: Cila ishte lëvizja e lodrës (topit)? Prej çfarë materiali është litari që lidh lodrën (topin) me dorën tonë? A e di ndonjëri si quhen këto materiale që zgjaten?</p>			

Prezantohet dhe diskutohen figurat e fq. 30 të librit.

**Kërkim:** Me materialet e marra nxënësit në grup do të zhvillojnë provën për gjetjen e përgjigjeve të pyetjes: Cili shirit elastik zgjatet më shumë? (porositen nxënësit për kujdesin ndaj syve). Gjatë vëzhgimit nxënësit plotësojnë *Fletët e punës 3.3a* (për nxënësit me arritje më të ulëta) dhe *3.3b* (për nxënësit me arritje më të larta), të cilat mbështesin këtë veprimtari. Në *Fletën e punës 3.3c* nxënësit krahasojnë dhe interpretojnë rezultatet nga hetimet e kryera mbi fijet elastike. Demonstroj tërheqjen e një kubi nëpërmjet llastikut. Pasi nxënësit e shohin veprimtarinë ata nxiten të formulojnë një pyetje të mirë shkencore për këtë veprimtari. Psh. “Çfarë ndodh me materialet kur i nënshtrohen tërheqjes?” ose “Cili është materiali më i fortë në tërheqje?” Nxënësit duhet të bëjnë parashikime të cilat mund t’i përshkruajnë në *Fletën e punës 3.3d*.

Nxënësit duhet të regjistrojnë rezultatet në tabelë dhe t’i krahasojnë ato me parashikimet.

**Përfundime:** Diskutojnë rreth atyre çfarë gjetën në mënyrë që të praktikojnë aftësinë shkencore të rishikimit dhe të shpjegimit të asaj çfarë ka ndodhur.

Nxiten nxënësit të japin mendime rreth vlefshmërisë së testit. Nëse fijet e materialit nuk janë të gjitha me të njëjtën gjerësi testi nuk do të jetë i vlefshëm. Gjithashtu, nëse nxënësit do t’i tërheqin vetë materialet, ata duhet të mendojnë rreth faktit nëse ata përdorën të njëjtën forcë në çdo rast ata mund të kenë tërhequr më fort materialet që nuk tërhiqeshin me lehtësi.

**Vlerësimi:** Në një fletë nxënësit plotësojnë thënien: “Unë mund të përshkruaj se si sillen materialet kur i nënshtrohen tërheqjes.” duke vendosur në të se në çfarë shkalle është dakord me thënien: dakord, i pasigurt, jo dakord.

Kjo do të japë një panoramë të faktit se sa të sigurt ndihen nxënësit kundrejt përmbajtjes së temës.

**Detyra:** Punimi i fq. 20, *Fletore pune*

- Gjeni një përdorim të fijes elastike në kushtet shtëpiake

**Refleksion:**

**Shënim: Tregoni kujdes:** Fijet elastike mund të këputen papritmas. Mbroni sytë.

Një tjetër veprimtari që mund të kryhet është: Nxënësit mund të përdorin fije elastike për të flakur apo për të shtyrë objektet përgjatë dyshemesë ose mbi një tavolinë. Këtu mund të testohen fije të ndryshme elastike, ose një fije elastike që shtyn një objekt nëpër sipërfaqet e ndryshme. Nxënësit mund të formulojnë pyetjen, “A sigurojnë fijet elastike më të gjëra forcë shtytëse më të madhe?” dhe të hetojnë rreth saj.

## Ora 16

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 2	Data
Tema mësimore: Nxehja dhe ftohja		Situata e të nxënit: Ngrohja e ushqimeve	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Eksploron dhe përshkruan mënyrën se si ndryshojnë materialet kur nxehen dhe kur ftohen, si psh. akulli, ushqimet, qiriu etj</li> <li>- Demonstron dhe vlerëson zbatimin e rregullave të sigurisë gjatë punës për nxehjen e materialeve;</li> <li>- Skicon dhe kryen një eksperiment të ndershëm, si p.sh. për tretjen e lëndëve në ujë, nxehjen dhe ftohjen e tyre etj.</li> </ul>			

<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Eksploron dhe përshkruan mënyrën se si disa materiale të përdorimit të përditshëm ndryshojnë formë gjatë ngrohjes apo ftohjes së tyre.</li> <li>- Përdor përvojën e drejtpërdrejtë për identifikimin e formave dhe veçorive të thjeshta dalluese.</li> <li>- Bën krahasime, rishikon dhe shpjegon atë çfarë ka ndodhur.</li> <li>- Mbledh prova nëpërmjet vëzhgimit ndërsa përpiqet t'i përgjigjet një pyetjeje shkencore.</li> <li>- Përdor burime të thjeshta të marrjes së informacionit.</li> <li>- Kryen matje të thjeshta dhe regjistron vëzhgime.</li> </ul>	<p><b>Fjalë kyçe:</b> nxehje, ftohje, shkrin, ftoh, i lëngët, i ngurtë, akull</p>
<p><b>Burimet:</b> enciklopedi, ilustrime,website: <a href="http://video.nationalgeographic.co.uk/video/environment/environment-natyr-al-disasters/volcanoes/volcano-lava/">video.nationalgeographic.co.uk/video/environment/environment-natyr-al-disasters/volcanoes/volcano-lava/</a></p> <p><b>Mjete:</b> ushqime të ndryshme (çokollatë, gjalpë, miell, oriz) qiri, orë ose kronometër</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Arte (Teknologji) Shkencë (Fizikë)</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <p><i>Diskutim për njohuritë paraprake:</i> Nxënësve u prezantohet figura e fq. 32 e librit dhe nxiten të gjejnë dhjetë materiale të ndryshme. Nëpërmjet pyetjeve nxënësit tregojnë mendimet e tyre: Sa materiale që ndryshojnë nëpërmjet procesit të ngrohjes mund të gjeni? A mund të tregoni mënyra sipas të cilave këto sende ndryshojnë?</p> <p>Disa sende ndryshojnë përmes shkrirjes; por p.sh. veza ndryshon në një mënyrë tjetër. Gjithashtu mund të dallohet fakti se disa sende, siç janë tiganët e gatimit, nuk ndryshojnë gjatë ngrohjes së tyre.</p> <p><i>Vëzhgim:</i> Demonstrrohet shkrirja e një cope çokollate në një gotë të vogël të zhytur në ujë të nxehtë. Diskutohet me nxënësit për të marrë idetë e tyre duke i orientuar në përdorimin e fjalëve kyç: Çfarë fjale duhet të përdorim për të përshkruar çokollatën në gjendje të ngurtë? Çfarë fjale duhet të përdorim për të përshkruar çokollatën në gjendje të lëngët? Si duhet ta përshkruajmë ndryshimin? (P.sh. çokollata shkrin, çokollata zbutet, çokollata kthehet në gjendje të lëngët.)</p> <p>U kërkohet nxënësve nëse mund të formulojnë pyetje të ndryshme që të mund t'i hetojnë më pas. U bëhet e ditur nxënësve se lëngjet si çokollata e shkrirë mund të nxehen shumë dhe mund të jenë të rrezikshme. Veprimtaritë në <i>Fletët e punës 3.4a</i> dhe <i>3.4b</i> kërkojnë nga nxënësit që të hetojnë ngrohjen e ushqimeve të ndryshme dhe të regjistrojnë vëzhgimet e nxënësve. Disa ushqime duhet të zbuten me qëllim që ndryshimi të jetë i dukshëm me sy të lirë (gjalpi, akullore). Disa materiale, për shembull, orizi, nuk ndryshojnë në temperaturën e dhomës. Kjo pikë duhet të diskutohet për shkak se shumë nga nxënësit kanë parë se orizi dhe ushqime të tjera gatuhen në temperatura më të larta në ujë të valuar. Nxënësit mund të regjistrojnë vëzhgimet e tyre në <i>Fletën e punës 3.4a</i>. Së bashku krahasohen rezultatet e marra dhe bëhen krahasime për të identifikuar veçoritë dalluese të tyre. Gjatë këtij procesi nxënësit do të rishikojnë dhe shpjegojnë faktet e ndodhura. (Kjo veprimtari mund të zgjerohet me produkte të tjera duke kërkuar nga nxënësit që t'i mbajnë materialet për një kohë më të gjatë. A vënë ata re ndonjë ndryshim në atë çfarë ndodh? Kjo veprimtari mund të jetë më e dobishme për nxënësit me arritje më të larta.)</p>	

Nxënësit do të vëzhgojnë nga afër djegien e qiririt si dhe do të shohin se si flaka shkrin dyllin dhe krijon një banjë të vogël me dyll të nxehtë në gjendje të shkrirë. Dylli i nxehtë tërhiqet nga fitili dhe më pas digjet. Është dylli që digjet, jo fitili. Kujtohen nxënësit që gjatë vëzhgimit përveç të parit, të përdorin edhe shqisat e tjera, siç janë shqisa e dëgjimit dhe e nuhatjes. Orientohen nxënësit figurën e fq. 33 të librit.

*Fleta e punës 3.4b* lidhet me hetimin e ngrohjes së copave të vogla ushqimore mbi flakën e një qiriu. Nxënësit ftohen të bëjnë parashikime rreth asaj se çfarë do të ndodhë dhe të regjistrojnë vëzhgimet, të cilat më pas do të krahasohen dhe do të diskutohen me të tjerët.

Përveç ngrohjes së materialeve, nxënësit do të vëzhgojnë materiale që ftohen pasi më parë kanë kaluar në ngrohje, për shembull, çokollata në gjendje të lëngët ose dylli i lëngshëm rikthehen në gjendje të ngurtë. Provohet dhe ftohja e lëngjeve. Nxënësit mund të vëzhgojnë një copë akull nga frigoriferi dhe shkrirjen e tij. Në këtë mënyrë vëzhgohet dhe diskutohet rreth fakteve që vihen re duke plotësuar *Fletën e punës 3.4c*.

*Prezantohet një video* me produktet e materialeve që kanë kaluar në procesin e ngrohjes; p. sh. përfitim i hekurit nëpërmjet shkrirjes dhe shpërthimi i vullkaneve duke bërë lidhje me Kapitullin 2 (Materialet shkëmbore) duke treguar që disa materiale shkëmbore ndryshojnë gjithashtu përmes proceseve të ngrohjes dhe të ftohjes. Gjatë vëzhgimit të videos diskutohen proceset që ndodhin dhe përfundimet duke përdorur termat e duhura shkencore: ngrohja, ftohja, shkrirja, i ngurtë dhe i lëngët.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për përsëkrimin e ndryshimit të disa materialeve të përdorimit të përditshëm gjatë ngrohjes dhe ftohjes së tyre. Për përdorimin korrekt të fjalorit. Kërkohe nga nxënësit që të diskutojnë rreth kohës së ndryshimit të ushqimeve të përgatitura në kuzhinë, p.sh. të një kokërr veze të skuqur në tigan apo të një kokërr veze të zierë me ujë. Si ndryshon kokrra e vezës?

**Detyra:** Punimi i fq. 21, *Fletore pune*

- Nxënësit mund të provojnë ftohjen e materialeve në kushtet shtëpiake (kjo detyrë sugjerohet të zhvillohet sipas dëshirës).

**Refleksion:** Ushqimi yt i preferuar hahet i ngrohtë apo i ftohtë?

**Shënim:** Familjariteti me ujin mund të nënkuptojë që nxënësit ta shohin procesin e shkrirjes si diçka që ndodh vetëm me ujin në gjendje të ngrirë (akullin). Veprimtaritë që lidhen me ngrohjen në këtë temë duhet t'i ndihmojnë nxënësit që të kuptojnë se ka edhe materiale të tjera që shkrijnë gjithashtu.

Mund të kryhet gatimi i kekut dhe të diskutohet për ndryshimet në materialet që po gatuhet.

**Kujdes:** Këshillohemi me rregulloren e shkollës që flet për flakët e zjarrit në klasë e shkollë. -Website paraqet një video të shkëmbit të shkrirë që rrjedh nga vullkanet: [video.nationalgeographic.co.uk/video/environment/environment-natyr-al-disasters/volcanoes/volcano-lava/](http://video.nationalgeographic.co.uk/video/environment/environment-natyr-al-disasters/volcanoes/volcano-lava/).

**Ora 17**

<b>Fusha:</b> Shkencë	<b>Lënda:</b> Dituri Natyre	<b>Klasa 2</b>	<b>Data</b>
<b>Tema mësimore:</b> Pse është i kripur deti? (ora 1)		<b>Situata e të nxënit:</b> Tretja e materialeve në ujë	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Identifikon materialet që treten në ujë.</li> <li>- Eksperimenton dhe përshkruan aftësinë tretëse të trupave.</li> <li>- Diskuton mbi rolin dhe rëndësinë e kripës si dhe mënyrat e nxjerrjes së saj.</li> </ul>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mëson faktin që disa materiale mund të treten në ujë.</li> <li>- Përdor përvojën e drejtpërdrejtë nëpërmjet veprimtarive të konkrete.</li> <li>- Parashikon se çfarë do të ndodhë përpara se të vendosë se çfarë do të bëjë.</li> <li>- Mëson faktin se një test apo krahasim mund të mos jetë i vlefshëm.</li> <li>- Bën matje të thjeshta, kryen dhe regjistron vëzhgimet.</li> <li>- Përdor disa mënyra për t'u treguar të tjerëve atë çfarë ndodhi.</li> <li>- Identifikon forma dhe veçori dalluese të thjeshta.</li> </ul>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> tret, parashikoj, e saktë</p>	
<p><b>Burimet:</b> enciklopedi, ilustrime</p> <p><b>Mjete:</b> kripë, gotë laborator, lugë, ujë, sheqer, copa xhelatine, miell, oriz, rërë.</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b></p>	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <p><i>Stuhi mendimi:</i> Pse uji i detit është i kripur?</p> <p>Pasi shkruhet kjo pyetje në tabelë ftohen nxënësit të japin mendime, hamendësime, çfarë kanë dëgjuar (çdo thënie është e pranueshme).</p> <p>Një pjesë e kripës vjen nga avullimi i ujit të detit, një pjesë nga uji i kripur që gjendet nëntokë. Këtu mund të ndihmojnë figurat në fillim të kësaj teme në fq. 34 të librit. Kripa është e tretur në ujin e detit, ajo nuk mund të shihet me sy, por dihet që është atje.</p> <p>Nxënësit diskutojnë rreth faktit se si e dinë ata që kripa ndodhet atje (mund të shihohet).</p> <p><i>Hetim1:</i> Të organizuar në dyshe, fillimisht u jepet nxënësve pak kripë dhe ujë duke theksuar faktin që kripa dhe uji janë substanca shumë të ndryshme nga njëra-tjetra. Nxënësit ftohen të tregojnë rreth këtyre materialeve se çfarë vënë re. Më pas diskutohet rreth asaj se çfarë do të ndodhë kur ata të përziejnë këto materiale.</p> <p>Nxënësit hedhin pak kripë në ujë dhe e trazojnë përzierjen me një lugë: “Çfarë vihet re gjatë trazimit?” Kripa duket sikur zhduket. Shpjegohet se kripa në të vërtetë nuk zhduket; ajo është akoma atje por nuk mund të shihet me sy të lirë pasi është tretur. Nxënësit mund të regjistrojnë vëzhgimet e tyre në <i>Fletën e punës 3.5a</i>.</p> <p><i>Hetim2:</i> Më tej ushtrimi përsëritet me substanca të tjera si: sheqer, copa xhelatine, miell, oriz, rërë. Shtrohet pyetja: Si do të matim sasinë e materialeve që do të hidhet në ujë? Do të përdoret e njëjta sasi mase një lugë për secilin material? Ftohen nxënësit të parashikojnë dhe pas veprimtarisë të regjistrojnë në <i>Fletën e punës 3.5b</i> përfundimet. Disa prej materialeve do të treten në ujë dhe disa jo.</p>			



*Hetim3:* Për të marrë përsëri kripën nga tretësira përdorim tretësirën me kripë të formuar më parë (mund t'i shtojmë edhe më shumë kripë për të patur mjaftueshëm). Do të lihet për disa ditë në një vend të ngrohtë. Plotësohen në *Fletën e punës 3.5c* parashikimet, të cilat do të krahasohen pas disa ditësh me përfundimet. Diskutohet pyetja: “Nëse tretim më shumë kripë në tretësirë a do të rimarrim më shumë kripë?”

*Harta e mendimit:* Në tabelë shkruhet: Tretja e materialeve në ujë.

Nxënësit bazuar në përfundimet e veprimtarive të kryera japin mendime për ndërtimin dhe klasifikimin e hartës së mendimeve.

**Vlerësimi:** Nxënësit vlerësohen për përshkrimin e veprimtarive, për përcaktimin e materialeve që treten ose jo.

**Detyra:** Punimi i fq. 22, *Fletore pune*

**Refleksion:**

**Shënim:** Kujdes nxënësit mund të ngatërrojnë shkrirjen me tretjen.

## Ora 18

<b>Fusha:</b> Shkencë	<b>Lënda:</b> Dituri Natyre	<b>Klasa 2</b>	<b>Data</b>
<b>Tema mësimore:</b> Pse është i kripur deti? ( Ora 2)		<b>Situata e të nxënit:</b> Tretja e materialeve	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Identifikon materialet që treten në ujë.</li> <li>- Eksperimenton dhe përshkruan aftësinë tretëse të trupave.</li> <li>- Diskuton mbi rolin dhe rëndësinë e kripës si dhe mënyrat e nxjerrjes së saj.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b>		<b>Fjalë kyçe:</b> tret, parashikoj, e saktë	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mëson faktin që disa materiale mund të treten në ujë.</li> <li>- Përdor përvojën e drejtpërdrejtë nëpërmjet veprimtarive të konkrete.</li> <li>- Parashikon se çfarë do të ndodhë përpara se të vendosë se çfarë do të bëjë.</li> <li>- Mëson faktin se një test apo krahasim mund të mos jetë i vlefshëm.</li> <li>- Bën matje të thjeshta, kryen dhe regjistron vëzhgimet.</li> <li>- Përdor disa mënyra për t'u treguar të tjerëve atë çfarë ndodhi.</li> <li>- Identifikon forma dhe veçori dalluese të thjeshta.</li> </ul>			
<b>Burimet:</b> enciklopedi, ilustrime		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b>	
<b>Mjete:</b> kripë, gotë laboratorit, lugë, ujë, sheqer, uthull, ujë me kripë, kola, lëng frutash, detergjent			
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b>			
<i>Diskutim për njohuritë paraprake:</i> Çfarë ndodh me kripën kur hidhet në ujë? A dallon tretja e kripës në varësi të temperaturës së ujit?			
Diskutim i përfundimeve të veprimtarisë së kryer në <i>Fletën e punës</i> fq. 22			
Shtrohet pyetja: Çfarë ndodh me kripën në ujë, zhduket apo mund ta rimarrim?			
<i>Hetim 3:</i> Pasi është lënë për disa ditë në një vend të ngrohtë tretësira me kripë do të shihet në enë nëse është rimarrë kripë nga tretësira. Plotësohen në <i>Fletën e punës 3.5c</i> përfundimet, të cilat krahasohen me parashikimet.			



<p><i>Hetim 4:</i> Nxënësve u kërkohet që të formulojnë një pyetje shkencore që kërkon përgjigje. P.sh. “Sa shumë sheqer tretet në lëngje të ndryshme?” ose, “Sa shpejt do të tretet një lugë me sheqer në lëngje të ndryshme?” Tabela në <i>Fletën e punës 3.5d</i> plotësohet me parashikimet se çfarë ata mendojnë se do të ndodhë. Më pas nxënësit ftohen të bëjnë sugjerime rreth faktit se si do të hetohet kjo pyetje. P.sh. nxënësit mund të fillojnë me sasi të njëjta të lëngjeve dhe më pas të shtojnë sasi të njëjta të sheqerit për çdo lëng, duke e trazuar mirë pas çdo shtimi të sasisë. Ata duhet të vazhdojnë që ta shtojnë sasinë e sheqerit derisa një sasi e vogël sheqeri të jetë e dukshme pas një trazimi të fortë. Nxënësit duhet të mbledhin rezultate dhe më pas të krahasojnë lëngjet për të parë se cili prej tyre do ta lejojë më shumë apo më pak tretjen e sheqerit. U drejtohet pyetja nxënësve: A është i drejtë testimi nëse ata përziejnë tretësit për periudha të ndryshme kohore?</p> <p>Nxënësit duhet të mendojnë edhe për mënyrën se si do të komunikojnë me të tjerët gjetjet e tyre.</p> <p><i>Përfundime:</i> Përfaqësuesit e dysheve prezantojnë gjetjet e tyre duke u dhënë mundësi dhe përfaqësuesve të tjerë të japin mendime në mbështetje apo për plotësim.</p>	
<p><b>Vlerësimi:</b> Nxënësit do të punojnë me njëri-tjetrin për të ndërtuar për këtë temë disa thënie të thjeshta të llojit “mundem-bëj”. P.sh. “Unë mund të kuptoj faktin pse disa materiale treten në ujë”, “Unë mund të kryej matje të thjeshta”, “Unë mund të përdor disa mënyra për t’u treguar të tjerëve atë çfarë ndodhi”. Nxënësit më pas duhet të vlerësojnë se sa afër afrohen me këto thënie: aspak, jo tamam, disi, plotësisht.</p>	
<p><b>Detyra:</b> Nxënësit mund të pyesin shokët apo familjarët nëse ata dinë diçka rreth faktit të tretjes së kripës në ujë dhe për faktin se përse mund të përdoret uji i kripur.</p>	<p><b>Refleksion:</b> Trego një ushqimin të cilin ti e përgatit vetë duke tretur materiale të njëri-tjetri.</p>
<p><b>Shënim:</b></p>	

## Ora 19

<b>Fusha:</b> Shkencë	<b>Lënda:</b> Dituri Natyre	<b>Klasa 2</b>	<b>Data</b>
<b>Tema mësimore:</b> Kontrolloni përparimin		<b>Situata e të nxënit:</b> Unë di...	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkruan ndryshimet që ndodhin te materialet, si rezultat i përkuljes, përdredhjes, zgjatje, ngjeshjes.</li> <li>- Eksploron dhe përshkruan mënyrën se si ndryshojnë materialet kur nxehen dhe kur ftohen, si psh. akulli, ushqimet, qiri etj.</li> <li>- Identifikon materialet që treten në ujë.</li> <li>- Eksperimenton dhe përshkruan aftësinë tretëse të trupave.</li> </ul>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rishikon përmbajtjen e të gjithë mësimeve dhe veprimtarive të punuara.</li> </ul>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> përkul, përdredh, tërheq, ngjesh, ndryshoj formë, elastik, nxehje, ftohje, shkrin, ftoh, i lëngët, i ngurtë, akull, tret</p>	

<p><b>Burimet:</b> enciklopedi, muralja e klasës Mjete: tabak letre, lapsa, ngjyra, vazot me farat e bimëve të mbjella në to.</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Arte (Teknologji)</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <i>Prezantimi</i> i muralës së plotësuar gjatë ditëve në lidhje me fjalët kyçe dhe përdorimin e tyre. Ftohen nxënësit të punojnë individualisht në plotësimin e fq. 36 dhe 37 të librit. <i>Përfundimet</i> diskutohen në dyshe dhe më pas me gjithë klasën.</p>	
<p><b>Vlerësimi:</b> Për shkallën e përvetësimit të njohurive shkathësive dhe qëndrime gjatë këtyre mësimëve. Për prezantimin e saktë dhe në forma të ndryshme të mendimeve duke përdorur fjalorin e përshtatshëm. Për komunikimin me të tjerët të ideve të tyre.</p>	
<p><b>Detyra:</b> Vizato diçka të re që mësove gjatë këtyre grup mësimësh.</p>	<p><b>Refleksion:</b></p>
<p><b>Shënim:</b> Nxënësit gjatë orës mësimore për argument të mendimeve mund të përdorin dhe shembuj nga enciklopeditë.</p>	

## Kapitulli 4: Drita dhe errësira

### Ora 20

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 2	Data
<b>Tema mësimore:</b> Burimet e dritës		Situata e të nxënit: Zbulojmë burime të ndryshme drite	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Zbulon burime të ndryshme drite, përveç Diellit.</li> <li>- Bën dallimin mes burimeve natyrore dhe artificiale të dritës.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b>		<b>Fjalë kyçe:</b> errësirë, elektrik dore	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Identifikon burime të ndryshme drite përfshirë Diellin.</li> <li>- Mbledh prova nëpërmjet kryerjes së vëzhgimeve ndërsa përpiqet që t'i përgjigjet një pyetjeje shkencore.</li> <li>- Përdor përvojën e drejtpërdrejtë nëpërmjet provës.</li> <li>- Parashikon se çfarë do të ndodhë përpara se të vendosë se çfarë do të bëjë.</li> <li>- Diskuton rreth rreziqeve të mundshme dhe mënyrës së shmangies së tyre.</li> <li>- Kryen dhe regjistron vëzhgime.</li> <li>- Bën krahasime për analizimin e provave.</li> <li>- Diskuton rreth parashikimeve (me gojë ose me shkrim), rreth rezultatit dhe pse ndodhi kështu.</li> <li>- Formulon pyetje dhe sugjeron mënyra përgjigjeje për to.</li> <li>- Bën sugjerime për mbledhjen e provave.</li> </ul>			
<b>Burimet:</b> enciklopedi, ilustrime		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b>	
<b>Mjete:</b> pëlhurë për të improvizuar një Dhomëz të Errët, objekte për t'u testuar, si: një libër, letër me shkëlqim, një pasqyrë, një shishe uji, një elektrik dore, si edhe burime të tjera drite		Arte (Art pamor)	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b>			
<i>Diskutim për njohuritë paraprake:</i> Çfarë dini rreth burimeve të dritës?			
Lihen nxënësit të diskutojnë tre minuta me njëri tjetrin dhe më pas të vizatojnë figura të burimeve të dritës.			
Zhvillohet bisedë me nxënësit rreth keq konceptimeve që ndeshen më shpesh si pasqyrat, dritaret dhe Hëna. Drita nuk vjen prej tyre por reflektohet prej tyre ose ato lejojnë kalimin e saj. Ato nuk janë burim drite. Për të nxitur këtë diskutim, përdorim figurën në fq. 38 të librit. Nxënësit do të identifikojnë sende që bëjnë dritë në klasë.			
<i>Hetim:</i> Krahasojnë nxënësit objektet që do të vëzhgojnë në dhomën e errët në mënyrë që të parashikojnë nëse objektet janë burime drite. Më pas ata duhet të mbledhin prova duke bërë vëzhgime në dhomëzën e errët.			
Bisedohet me nxënësit për të vendosur se çfarë do të bëjnë sapo të futen në dhomëzën e errët. Kërkohet mendim nga ata nëse është më e saktë nga ana shkencore që të testohen burimet e dritës një nga një ose të gjitha bashkë.			

Nxiten nxënësit të bëjnë sugjerime rreth faktit se si të testojnë objekte që ata mendojnë se nuk janë burime drite dhe si të vendosin se çfarë të bëjnë. Nxënësit duhet të sqarohen se ata kanë nevojë që t'i vështrojnë këto objekte me të gjitha burimet e dritës të fikura. Hartohet së bashku me nxënësit një listë e shkurtër udhëzimesh që mund të vendoset në një poster jashtë dhomëzës së errët. Nxënësit do të punojnë në grupe (ose dyshe), për të hetuar me saktësi nëse një send është apo jo burim drite. Sendet që reflektojnë dritën, siç janë pasqyrat, do të duken të errëta në dhomëzën e errët pasi nuk ka dritë brenda që të mund të reflektohet nga ato sende. Në dhomëzën e errët do të ndriçojnë vetëm burimet e dritës. Objekte si elektrikë dore dhe burime të tjera drite të tilla si fenerët e biçikletave, lodra apo yje që shkëlqejnë në errësi dhe ndoshta edhe një ekran të vogël tableti apo telefoni celular do të jenë burime drite që do të vëzhgohen. Është e rëndësishme për nxënësit që të testojnë objekte të jetës së përditshme që nuk janë burime drite, siç janë vizoret, lapsat dhe librat, po ashtu edhe objektet që mund të ngatërrojnë nxënësit si xhaketat apo rripat fosfoeshentë, pasqyrat plastike dhe materiale të tjera të ndritshme. Kur të testohen qirinjtë apo shkrepëset, zhvillohet bisedë me nxënësit rreth problemeve të sigurisë.

Përdoret *Fleta e punës 4.1a* për të regjistruar parashikimet si edhe krahasimet e vëzhgimet që japin rezultate.

Ndërtohet karta fjalori për të ndihmuar nxënësit në përdorimin e fjalorit të kësaj teme. Për këtë përdorni *Fletën e punës 4.1b*.

Bisedohet me nxënësit për lidhjen midis dritës dhe nxehtësisë. Disa burime të dritës janë shumë të nxehtë. Kjo ndodh se materialet lëshojnë dritë kur janë shumë të nxehtë. Metalet dhe materialet shkëmbore kur janë të nxehtë lëshojnë dritë të kuqe/portokalli.

*Përfundime:* Pas hetimit, diskutohet me nxënësit për të krahasuar parashikimet me rezultatet e tyre.

**Vlerësimi:** Nxënësit i tregojnë njëri-tjetrit rezultatet e tyre të regjistruara dhe diskutojnë rreth asaj që kanë gjetur. Kërkohe nga nxënësit të dallojnë ngjashmëritë dhe ndryshime në rezultatet e tyre. (Çdo ndryshim mund të ketë nevojë që të testohet përsëri. Kjo i nxit nxënësit të zbatojnë objektivin e hetimit shkencor për të përdorur një shumëllojshmëri mënyrash në paraqitjen e asaj çfarë ndodhi.)

**Detyra:** Punimi i fq. 23, *Fletore pune*

**Refleksion:** Si u ndjetë në Dhomën e errët?

**Shënim:** Për të ndërtuar një vend të errët, ose një "Dhomë të Errët", mbuloni një tavolinë me një pëlhurë të trashë dhe të errët, pasi këto pëlhura bllokojnë më mirë dritën. Sa më shumë pëlhura të përdoren, aq më e errët do të jetë dhomëza e errët. Çdo e çarë do të lejojë kalimin e një sasive të madhe drite, kështu që sigurohuni që hyrja e dhomëzës të ketë mbulesë dyfishe dhe copat e pëlhurës të jenë aq të gjata sa të arrijnë në dysheme. Nëse është e nevojshme mund të përdoret edhe shirit ngjitës për të bashkuar copat e pëlhurës.

-Shumë nxënës mendojnë se Hëna është burim drite. Disa nxënës mund të mendojnë se sipërfaqet e ndritshme, siç janë pasqyrat dhe uji, janë burime drite. Shpjegoni se drita vjen nga këto sende, por ato nuk e lëshojnë vetë dritën. Drita prodhohet nga një burim drite dhe më pas pasqyrohet nga sipërfaqja e këtyre objekteve. Nxënësit mund ta testojnë këtë duke marrë pasqyra ose një shishe uji në dhomëzën e errët pa burime drite. Të dyja sendet do të duken të errëta.

Disa nxënës mund të mos kuptojnë që yjet janë burime drite. U shpjegohet që edhe Dielli ynë është një yll por që ndodhet shumë më pranë nesh se yjet e tjerë.

**Kujdes:** kujdes me flakën e qiririt dhe të shkrepësës.

**Ora 21**

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 2	Data
<b>Tema mësimore:</b> Errësira		<b>Situata e të nxënit:</b> A mund të shohim në errësirë?	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b> - Koncepton errësirën si mungesë e dritës.			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b> - Mëson faktin që errësira është gjendja e mungesës së dritës. - Mbledh prova nëpërmjet vëzhgimeve ndërsa përpriqet që t'i përgjigjet një pyetje shkencore. - Përdor përvojën e drejtpërdrejtë. - Parashikon se çfarë do të ndodhë përpara se të vendosë se çfarë do të bëjë. - Kryen dhe regjistron vëzhgime në lidhje me pyetjen e hetimit. - Përdor disa mënyra për t'u treguar të tjerëve atë çfarë ndodhi. - Diskuton rreth parashikimeve (me gojë dhe me shkrim), rreth rezultatit të nxjerrë dhe shkakut të tij. - Rishikon dhe shpjegon çfarë ndodhi.		<b>Fjalë kyçe:</b> errësirë, elektrik dore	
<b>Burimet:</b> enciklopedi, ilustrime <b>Mjete:</b> një kuti kartoni me kapak, një objekt i vogël që mund të futet në kuti, elektrik dore ose fener		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b>	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <i>Bisedë:</i> Zhvillohet bisedë me nxënësit rreth rasteve kur ata kanë qenë në kushtet e errësirës. Pyeten nxënësit si janë ndjerë dhe pse mendojnë se disa njerëz tremben në errësirë. Ftohen nxënësit të përshkruajnë ndonjë situatë që tregon se ndonjëherë mund të jetë diçka gazmore të qëndrosh në errësirë. P.sh. të dalësh jashtë natën dhe të shohësh Hënën dhe yjet kur udhëtojnë dhe shohin ndriçimin e rrugës, festimeve të ndryshme të zhvilluara natën ku përdoren fishekzjarrë, pishtarë apo zjarre festive, etj. <i>Hetimi 1:</i> Nxënësit ftohen që të mbulojnë sytë me duar dhe që të përshkruajnë çfarë shohin. Shpjegohet se që të jetë errësirë e plotë duhet të bllokojmë të gjitha burimet e dritës. Diskutohet figura në fq. 40 të librit. Shtrohet pyetja: Pse ka pakëz dritë natën në dhomën e gjumit? Kjo vjen nga dritat e rrugëve ose nga ndonjë burim i brendshëm drite, si nga ndonjë orë dixhitale apo nga sytë magjikë të disa pajisjeve shtëpiake. <i>Hetimi 2:</i> Vëzhgohet figura dhe prezantohet zhvillimi i hetimit të radhës nëpërmjet kutisë së errët. Në dyshe nxënësit parashikojnë nëse do ta shohin objektin për çdo herë, përpara se ata të mbledhin prova nga vëzhgimet. Kur nxënësit të shohin fillimisht në brendësi të kutisë përmes vrimës së shikimit, vrima e sipërme duhet të jetë e mbyllur. Duhet të jetë shumë errët brenda në kuti me qëllim që objekti të mos shihet. Nëse ka akoma pakëz dritë, duhet t'i mbuloni të gjitha të çarat ose të përdorni një vrimë më të vogël shikimi. Herën e dytë, hapni të çarën në majë të kutisë që të hyjë pakëz dritë. Nxënësit vështrojnë përsëri. Tani ata do të shohin diçka. Por mund ta kenë të vështirë të zbulojnë se çfarë objekti është brenda në kuti. Që nxënësit të punojnë në çift njëri prej tyre të mbajë fenerin e ndezur përmes të çarës së majës ndërsa tjetri të shohë përmes vrimës së shikimit. Vetëm tani nxënësit mund ta dallojnë plotësisht objektin.			

Më pas, krahasohen rezultatet me parashikimet e bëra. Nxënësit përdorin <i>Fletën e punës 4.2</i> për të regjistruar vëzhgimet dhe për t'u treguar të tjerëve çfarë ndodhi. <i>Përfundime:</i> Tani nxënësit japin mendimet në lidhje me pyetjen: A mund të shohim në errësirë?	
<b>Vlerësimi:</b> Kërkohet nga nxënësit që të punojnë në çift dhe të përshkruajnë me radhë etapat e punës së kryer prej tyre. Zgjidhen dyshe nxënësish që të përsërisin shpjegimet e tyre për të gjithë klasën.	
<b>Detyra:</b> Punimi i fq. 24, <i>Fletore pune</i>	<b>Refleksion:</b>
<b>Shënim:</b> Nëse nxënësit me arritje më të ulëta kanë vështirësi me veprimtarinë e kutisë së errët, hiqet kapaku i kutisë dhe vendoset kutia brenda dhomëzës së errët të përshkruar në Temën 4.1. Kërkohet nga këtë nxënës të futen brenda dhomëzës së errët fillimisht pa ndonjë burim drite. Më pas kërkohet nga ata të përdorin një elektrik dore për të identifikuar objektin brenda kutisë.	

## Ora 22

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 2	Data
<b>Tema mësimore:</b> Formimi i hijeve		<b>Situata e të nxënët:</b> Në sheshin e lojërave	
<b>Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave të fushës:</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkruan si formohet hija.</li> <li>- Bën lidhjen mes formës e madhësisë së hijes dhe pozicionit të objektit e burimit të dritës.</li> <li>- Planifikon në grup një veprimtari, ku shfrytëzon forma të ndryshme të hijeve, si p.sh. një shfaqje me hije, ekspozitë etj.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënët sipas temës:</b>		<b>Fjalë kyçe:</b> hija	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Identifikon hija të ndryshme.</li> <li>- Përdor përvojën e drejtpërdrejtë në vëzhgim e regjistrim e të dhënave për to.</li> <li>- Identifikon forma dhe veçori të thjeshta dalluese.</li> <li>- Diskuton rreth rreziqeve dhe mënyrave të shmangies së tyre.</li> </ul>			
<b>Burimet:</b> enciklopedi, ilustrime Mjete: shkumës, letër, elektrik dore		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Art (Art pamor)	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b>			
<i>Bisedë:</i> Kërkohet nga nxënësit të thonë se çfarë dinë ata për hijet. Kur i shohin hijet dhe format e tyre? Tregoni burime të dritës jashtë klasës.			
Diskutohet me nxënësit pse nuk duhet të shihet Dielli drejtpërsëdrejti me sy të lirë. Rreziqet e mundshme dhe shmangia e tyre.			
<i>Lojë 1:</i> Të organizuar në dyshe nxirren nxënësit në oborrin e shkollës. Njëri nga nxënësit të bëjë hija ndërsa tjetri të vizatojë me shkumës formën e hijes së trupit të nxënësit të parë. Më pas mund të ndërrohen rolet. Nxënësit mund të vizatojnë hija të ndryshme interesante nëpërmjet ndryshimit të pozicionit të tyre.			
Sfidohen nxënësit të bëjnë një hapësirë midis vetes dhe hijes së tyre. Ata mund ta bëjnë këtë nëpërmjet kërcimit.			
Pyeten nxënësit nëse mund të prekin kokën e hijes së tyre. Ata mund ta bëjnë këtë duke u kërrusur ose duke qëndruar në këmbë në mënyrë që hija e tyre të bjerë mbi një mur.			

Pas këtyre veprimtarive, për të regjistruar vëzhgimet e tyre të drejtpërdrejta, përdoret *Fleta e punës 4.3a*.

*Lojë 2:* Nëse një nxënës vizaton formën e hijes së trupit të vet, një nxënës tjetër duhet të përpiqet të bëjë të njëjtën hije dhe të lëvizë derisa hija e tij të përputhet me formën e hijes së vizatuar të nxënësit të parë. Nxënësit vëzhgojnë me kujdes hijet pasi ata do të duhet t'i vizatojnë përsëri kur të kthehen në klasë. Për të kuptuar pozicionin e hijeve të tyre, ata me një dorë të tregojnë Diellin dhe me dorën tjetër të tregojnë hijen e tyre. Nxënësit duhet të identifikojnë faktin se hija e tyre shtrihet në drejtim të kundërt me Diellin.

Gjithashtu nxënësit do të gjejnë dhe të formojnë hije të tjera si ato të pemëve, të objekteve në sheshin e lojërave dhe të ndërtesave të ndryshme

*Lojë 3:* U jepen nxënësve disa objekte të vogla dhe elektrikë dore. Objektet mund të jenë forma të vogla 3D, modele njerëzish si edhe lodra të tjera të vogla. Duke punuar në çift, nxënësit do të vendosin objektin në letër dhe të përdorin elektrikun e dorës për të marrë hijen e objektit. Kërkohet nga nxënësit që të vizatojnë format e hijes dhe të shohin lidhjen midis objektit dhe hijes. Vëzhgimet regjistrohen në *Fleta e punës 4.3b* (errësohet pamja e klasës duke ulur grilat ose duke vendoset perde të errëta mbi dritare).

Pas kthimit në klasë, nxënësit regjistrojnë vëzhgimet e tyre nëpërmjet vizatimit të një figure të vetvetes, të Diellit dhe të hijes së tyre. U tërhiqet vëmendja nxënësve për pozicionin e hijes së tyre kundrejt Diellit.

*Përfundime:* Prezantohen nga disa nxënës vëzhgimet dhe regjistrimet në fletët e punës. Diskutohen së bashku ato: Kur formohet hija? Çfarë është e nevojshme për të realizuar hijen? A ka hija hundë ose sy? A mund të vihen re detaje të veshjeve? A është hija e bashkuar me ata vetë? Kërkohet nga nxënësit me arritje më të larta të parashikojnë se çfarë do të ndodhë nëse do të provojnë të marrim të njëjtën hije por një çast tjetër kohor? (Këta nxënës mund t'i testojnë parashikimet e tyre më vonë gjatë ditës.) Tregohet rreth sa më shumë karakteristikave të hijes. Diskutohen figurat në fq. 42, 43 të librit. ku paraqiten figura të hijeve interesante, si dhe një figurë që tregon se një objekt mund të ketë më shumë se një hije nëse ekspozohet kundrejt më shumë se një burimi drite.

**Vlerësimi:** Kërkohet nga nxënësit të shohin vizatimet e hijeve të njëri-tjetrit dhe të thonë një gjë që ata pëlqejnë në to dhe një gjë që mund të përmirësohet.

**Detyra:** Punimi i fq. 25, *Fletore pune*

**Refleksion:**

**Shënim:** Nxënësit duhet të paralajmërohen që në asnjë rast të mos shohin drejtpërsëdrejti me sy të lirë burimet e forta të dritës, veçanërisht Diellin, pasi kjo mund të dëmtojë sytë e tyre.

## Ora 23

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 2	Data
<b>Tema mësimore:</b> Format e hijes		<b>Situata e të nxënët:</b> Formojmë hije	
<b>Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave të fushës:</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkruan si formohet hija.</li> <li>- Bën lidhjen mes formës e madhësisë së hijes dhe pozicionit të objektit e burimit të dritës.</li> <li>- Planifikon në grup një veprimtari, ku shfrytëzon forma të ndryshme të hijeve, si p.sh. një shfaqje me hije, ekspozitë etj.</li> <li>- Skicon një provë të ndryshme për të gjetur pse ndryshon madhësia e hijes dhe forma e saj (pozicioni i burimit dhe i objektit).</li> </ul>			



<p><b>Rezultatet e të nxënës sipas temës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Identifikon hije të ndryshme.</li> <li>Përdor përvojën e drejtpërdrejtë në vëzhgim e regjistrim e të dhënave.</li> <li>- Përdor burime të thjeshta të marrjes së informacionit.</li> <li>- Identifikon forma dhe veçori dalluese të thjeshta.</li> <li>- Rishikon dhe shpjegon atë çfarë ka ndodhur.</li> </ul>	<p><b>Fjalë kyçe:</b> hije</p>
<p><b>Burimet:</b> enciklopedi, ilustrime</p> <p><b>Mjete:</b> burim drite, muri, karton, gërshtë, ngjytës</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhë (Gjuhë shqipe), Art (Art pamor)</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <p><i>Lojë:</i> Në një ditë me diell nxirren nxënësit jashtë klasës dhe u kërkohet të punojnë së bashku për të krijuar forma të ndryshme hijesh, duke përdorur trupin, krahët dhe këmbët e tyre. Në lojë nxënësit sfidojnë njëri tjetrin me hije që ka më shumë se dy krahë, dy gjymtyrë dhe një kokë. Gjithashtu krijohen format e paraqitura në fq. 44 të librit.</p> <p><i>Diskutim për njohuri paraprake:</i> Nxiten nxënësit ti japin përgjigje pyetjes ”Pse hija ka pjesë të ndriçuara dhe të errëta?”</p> <p><i>Veprimtari:</i> Nxënësit në grupe punojnë ndërtimin e formave për ti përdorur si personazhet e një përralle si në fq. 45 të librit. Ata punojnë në grupe për të krijuar një shfaqje të thjeshtë teatrale duke përdorur figurat e tyre. Shfaqja mund të përmbajë një pjesë të njohur për nxënësit. Grupet e nxënësve shfaqin lojën e tyre tek grupet e tjera, duke përdorur një ekran (p.sh. murin) dhe një projektor (p.sh. elektrik dore).</p> <p><i>Diskutim:</i> Dilet në përfundime në lidhje me pyetjen ”Pse hija ka pjesë të ndriçuara dhe të errëta?”</p> <p>-Ndryshohet madhësia e hijes duke zhvendosur figurën më afër ose më larg ekranit. Sfidohen nxënësit me arritje më të larta që ta demonstrojnë këtë veprim dhe t’u shpjegojnë të tjerëve mundësinë e rritjes apo të zvogëlimit të madhësisë së hijes.</p> <p>Në Ushtrimin 4.4 në Fletoren e punës, nxënësit diskutojnë rreth lidhjes midis një objekti dhe formës së tij. Nga nxënësit kërkohet të parashikojnë hijen e objekteve të thjeshta.</p>	
<p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit gjatë përshkrimit të çdo ndryshimi midis parashikimeve dhe rezultateve. Përcaktimet e ndryshimeve midis tyre duke treguar, pse.</p>	
<p><b>Detyra:</b> Punimi i fq. 26, <i>Fletore pune</i></p>	<p><b>Refleksion:</b> Nxënësit të shohin vizatimet e hijeve të njëri-tjetrit dhe të thonë një gjë që ata pëlqejnë në to dhe një gjë që mund të përmirësohet.</p>
<p><b>Shënim:</b> Mbështeten nxënësit me arritje më të ulëta duke u dhënë atyre për hetim disa forma më të thjeshta.</p> <p>Disa nxënës mund të provojnë të vizatojnë hije me tipare të fytyrës dhe detaje të veshjes. Nxitën të vëzhgojnë me shumë kujdes hijet dhe imazhet në tërësi dhe jo në detaje</p> <p>Përdorimi i internetit: <a href="http://www.kellys.com/ashley/shadow.html">www.kellys.com/ashley/shadow.html</a>: Në këtë adresë ka më shumë forma figurash të formuara me ndihmën e duarve:</p> <p>Website i mëposhtëm përfshin më shumë modele të gatshme për formimin e figurave nëpërmjet përdorimit të kartonit: <a href="http://home.comcast.net/~pizzicatopuppets/myshadow.html">home.comcast.net/~pizzicatopuppets/myshadow.html</a>.</p> <p>Në këtë adresë është video e ‘Hijes së dorës’: <a href="http://www.saxton.com.au/raymond-crowe/#videos">www.saxton.com.au/raymond-crowe/#videos</a>.</p> <p>Kjo video tregon përgatitjen e figurave të përdorura në një shfaqje: <a href="http://www.bbc.co.uk/learning-zone/clips/how-shadows-are-made-shadow-puppets/2175.html">www.bbc.co.uk/learning-zone/clips/how-shadows-are-made-shadow-puppets/2175.html</a>.</p>	



**Ora 24**

<b>Fusha: Shkencë</b>	<b>Lënda: Dituri Natyre</b>	<b>Klasa 2</b>	<b>Data</b>
<b>Tema mësimore:</b> Kontrolloni përparimin		<b>Situata e të nxënit:</b> Unë di...	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zbulon burime të ndryshme drite, përveç Diellit.</li> <li>- Bën dallimin mes burimeve natyrore dhe artificiale të dritës.</li> <li>- Koncepton errësirën si mungesë e dritës.</li> <li>- Përshkruan si formohet hija.</li> <li>- Bën lidhjen mes formës e madhësisë së hijes dhe pozicionit të objektit e burimit të dritës;</li> <li>- Demonstron pasqyrimin e dritës.</li> <li>- Tregon rolin e mjeteve mbrojtëse të syrit ndaj dritës së fortë.</li> <li>- Planifikon në grup një veprimtari, ku shfrytëzon forma të ndryshme të hijeve.</li> <li>- Skicon një provë të ndershme për të gjetur pse ndryshon madhësia e hijes dhe forma e saj.</li> </ul>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rishikon përmbajtjen e të gjithë mësimeve dhe veprimtarive të punuara.</li> </ul>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> errësirë, burim drite, elektrik dore, hije</p>	
<p><b>Burimet:</b> enciklopedi, muralja e klasës</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Arte (Art pamor)</p>	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <p><i>Prezantimi</i> i muralës së plotësuar gjatë ditëve në lidhje me fjalët kyçe dhe përdorimin e tyre. Frohen nxënësit të punojnë individualisht në plotësimin e fq. 46 dhe 47 të librit.</p> <p><i>Përfundimet</i> diskutohen në dyshe dhe më pas me gjithë klasën.</p> <p>Për t'i vërtetuar përfundimet nxënësit përdorin dhe demonstrimin.</p>			
<p><b>Vlerësimi:</b> Për shkallën e përvetësimit të njohurive shkathësive dhe qëndrime gjatë këtyre mësimeve. Për prezantimin e saktë dhe në forma të ndryshme të mendimeve duke përdorur fjalorin e përshtatshëm. Për komunikimin me të tjerët të ideve të tyre.</p>			
<p><b>Detyra:</b> Trego në mënyrën tënde të preferuar momentin më të bukur gjatë këtyre grup mësimesh.</p>		<p><b>Refleksion:</b></p>	
<p><b>Shënim:</b> Në varësi të kohës nxënësit gjatë orës mësimore mund të zhvillojnë përsëri lojëra me hijet.</p>			

## Kapitulli 5: Elektriciteti

### Ora 25

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 2	Data
<b>Tema mësimore:</b> Elektriciteti rreth nesh		<b>Situata e të nxënit:</b> E përdor apo jo elektricitetin?	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b> - Vlerëson rolin e elektricitetit në jetën e përditshme.			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b> - Mbledh prova nëpërmjet kryerjes së vëzhgimeve, ndërsa përpiqet që t'i përgjigjet një pyetjeje shkencore. - Përdor burime të thjeshta të informacionit. - Përdor përvojën e drejtpërdrejtë në kërkimin e të dhënave mbi elektricitetin.		<b>Fjalë kyçe:</b> elektriciteti, elektriciteti i rrejtit, pilë, bateri	
<b>Burimet:</b> enciklopedi, ilustrime <b>Mjete:</b> pajisje të vogla që punojnë me bateri, bateri, gërshërë, ngjites		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b>	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <i>Diskutim për njohuri paraprake:</i> Pyeten nxënësit se çfarë dinë rreth elektricitetit. Pasi ata kanë dhënë mendimet për të nxitur diskutimin orientohen të shohin figurën në fq. 48 të Librit. Më pas nxënësit ftohen të vizatojnë objekte që përdorin elektricitetin ose që përdoren për mbrojtjen nga ai. Në dyshe ata shpjegojnë e diskutojnë çfarë dinë në lidhje me elektricitetin tek objekti që kanë vizatuar. -U prezantohen nxënësve shkurtimisht masat mbrojtëse gjatë punës në rrejtin kryesor të furnizimit me energji elektrike. Nxënësit mund të prekin pajisjet elektrike vetëm në rastet kur një i rritur u tregon atyre që ato janë të sigurta. U drejtohet nxënësve pyetja: A e dini se nga vjen elektriciteti? Punohet fq. 49 e librit me fotografinë e centralit elektrik dhe kërkohet nga nxënësit të vështronë linjat e transmetimit. Pyes nëse ata kanë parë linja të transmetimit të energjisë që kalojnë mbi shtëpitë e tyre. <i>Kërkim:</i> Ftohen nxënësit të shohin në klasë dhe të identifikojnë objekte që punojnë me elektricitet (në klasë janë sjellë objekte si radio dore, elektrik dore, orë muri, etj të cilat punojnë me bateri). <i>Ditari dypjesësh:</i> Në dërrasën e zezë bëhet një tabelë ku në njëren kolonë të saj shkruhen emrat e objekteve të dalluara dhe në tjetrën kolonë nëse elektricitetin e marrin nga rrjeti apo nga bateria.			

<p><i>Veprimtari:</i> Para nxënësve prezantohet bateria e orës së murit, ndërkohë nxënësit në dyshe kanë bateritë e tyre. U kërkohet nxënësve të gjejnë në skajet e baterive dy shenjat (+) dhe (-). (Disa bateri mund të kenë të emërtuar vetëm njërin fund.) U shpjegohet se zakonisht pajisjet nuk punojnë nëse bateritë vendosen në mënyrën e gabuar. Gjithmonë ka një figurë që tregon mënyrën e vendosjes së baterive. U jepen nxënësve disa pajisje që punojnë me bateri dhe së bashku duke ndjekur demonstrimin nxënësit vendosin baterinë në pajisjet e shpërndara tek ata. Bateritë do të vendosen në atë mënyrë që të mundësohet funksionimi i pajisjes. Diskutohet rreth përparësive dhe mangësive të përdorimit të baterive. Bateritë janë të lëvizshme por që “shkarkohen” – pra, humbasin fuqinë.</p> <p><i>Plotësi i organizuesit grafik:</i> nëpërmjet <i>Fletëve të punës 5.1</i> nxënësit do të presin figurat për t’i vendosur në vendin e duhur” Përdorin elektricitetin / nuk e përdorin elektricitetin”.</p>	
<p><b>Vlerësimi:</b> Kërkohet nga nxënësit (në dyshe) që t’i tregojnë njëri-tjetrit pajisjen e tyre më të preferuar që përdorin ushqimin e rrjetit kryesor dhe që përdorin bateritë. Nxënësit duhet t’i shpjegojnë njëri-tjetrit preferencat e tyre. Nxënësit të kontrollojnë nëse shoku i tyre ka një preferencë si të tijën. Njërin prej tyre do t’i tregojnë klasës preferencat e shokut të tij.</p>	
<p><b>Detyra:</b> Punimi i fq. 27, <i>Fletore pune</i> Nxënësit do të përdorin burime të thjeshta të informacionit si librat joartistikë, për të zbuluar fakte të reja rreth elektricitetit.</p>	<p><b>Refleksion:</b></p>
<p><b>Shënim:</b> Disa pajisje kanë kapakë për bateritë dhe mund të jenë të vështirë për t’u hequr ose janë të vendosura në fole. Është e nevojshme heqja e tyre përpara fillimit të veprimtarisë. Përdorimi i internetit: <a href="http://www.switchedonkids.org.uk/where_does.html">www.switchedonkids.org.uk/where_does.html</a>. Në këtë website interaktiv bëhet fjalë për mënyrat e prodhimit të elektricitetit.</p>	

## Ora 26

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 2	Data
<p><b>Tema mësimore:</b> Mbrojtja nga elektriciteti</p>		<p><b>Situata e të nxënët:</b> Si të mbrohemi nga elektriciteti?</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave të fushës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerëson rolin e elektricitetit në jetën e përditshme.</li> <li>- Demonstron dhe vlerëson zbatimin e rregullave të sigurisë gjatë punës me elektricitet.</li> <li>- Punon në grup për hartimin e një posteri mbi rregullat e sigurisë gjatë punës me elektricitet dhe e prezanton atë.</li> </ul>			
<p><b>Rezultatet e të nxënët sipas temës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përdor burime të thjeshta të informacionit.</li> <li>- Bisedon rreth rreziqeve dhe mënyrave të shmangies së tyre.</li> <li>- Përdor disa mënyra për t’u treguar të tjerëve atë çfarë ndodhi.</li> </ul>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> tel përçues, goditje elektrike</p>	
<p><b>Burimet:</b> enciklopedi, ilustrime Mjete: karton, ngjyra, gërshtë, ngjitës</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Gjuhë (Gjuhë shqipe), Art (Art pamor)</p>	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> Diskutohen plotësimet e detyrave të shtëpisë duke kërkuar nga nxënësit të tregojnë se cilat prej objekteve që e marrin elektricitetin nga bateria apo nga rrjeti përdorin elektricitetin kanë nevojë për bateri dhe cilat kanë nevojë për rrjetin kryesor të furnizimit me energji elektrike. <i>Stubi mendimi:</i> A duhet të mbrohemi nga elektriciteti? Çfarë dini për të? Çfarë dini mbi rreziqet që lidhin elektricitetin me ujin?</p>			

*Përmbledhje e strukturuar:* U shpjegohet nxënësve se rrjeti kryesor i furnizimit me energji elektrike është shumë i fuqishëm dhe duhet të përdoret me kujdes. Nxënësit në asnjë rast nuk duhet të prekin me duar pajisjet që shfrytëzojnë këtë rrjet derisa një person i rritur t'u tregojë atyre se përdorimi i këtyre pajisjeve është diçka e sigurt. Prezantohen ilustrime figurash si dhe figurat e fq. 50 dhe 51 të Librit. Tregohen pjesë të rrjetit të furnizimit me energji elektrike në mjediset jashtë shtëpisë. Udhëzohen nxënësit rreth faktit të qëndrimit larg nga nënstacionet elektrike dhe linjat e transmetimit të energjisë. Zhvillohet bisedë rreth mbrojtjes nga elektriciteti.

Pasi kërkohet nga nxënësit të shpjegojnë çfarë dinë mbi rreziqet që lidhin elektricitetin me ujin u shpjegohet që elektriciteti i rrjetit kryesor të furnizimit është kaq i fuqishëm sa mund të përshkojë edhe ujin (elektriciteti i prodhuar nga bateritë nuk është kaq i fuqishëm, veçse nëse uji është shumë i kripur).

Sqarohen nxënësit se në këtë kapitull do të hetohen vetëm qarqet që përdorin bateritë dhe kjo është një veprimtari *shumë e sigurt*. Bëhet i qartë që hetimi i rrjetit kryesor elektrik paraqet rreziq.

-Ndahen nxënësit në grupe. Grupeve u jepet për detyrë të ndërtojnë një poster ose të ndërtojnë një pjesë teatrale. (pjesëmarrjen në grupe nxënësit mund ta bëjnë me dëshirë)

*Ndërtimi i posterit:* Ftohen nxënësit që në grupe të ndërtojnë një poster për t'u treguar të tjerëve si të mbrohen gjatë punës me rrjetin kryesor të energjisë. Tërhiqet vëmendja: nxënësit duhet të mendojnë se si do ta paraqesin informacionin, duke përdorur më shumë fjalë apo duke përdorur më shumë figura.

*Përgatitja e pjesës teatrale:* Nxënësit do të punojnë në grupe të vogla për të ndërtuar dhe shfaqur një pjesë të shkurtër teatrale, duke demonstruar rregullat e mbrojtjes nga elektriciteti. U shpjegohet nxënësve të mos imitojnë ndonjë goditje elektrike, por shfaqja e tyre duhet të përfundojë duke paraqitur një nxënës që ndalon një nxënës tjetër që të kryejë një veprim të rrezikshëm dhe që i shpjegon atij pse veprimi që po kryen është me rrezik. (Nëse nxënësit do të performojnë në heshtje, atëherë nxënësit e tjerë mund të përpiqen që të parashikojnë skenarin e mundshëm të mbrojtjes nga elektriciteti.)

*Prezantimi i posterave dhe pjesëve teatrale nga grupet.*

**Vlerësimi:** Vlerësohen nxënësit për prezantimin korrekt duke përdorur fjalorin e duhur dhe argumentuar qartë kujdesin ndaj elektricitetit.

**Detyra:** Punimi i fq. 28, *Fletore pune*

**Refleksion:** Si mendon ti, cili prej personazheve të teatrit kishte të drejtë?

**Shënim:** Për punimin e posterit nxënësit mund të përdorin dhe nga faktet e mbledhura nga detyrat e mëparshme.

Nxënësit me arritje më të ulëta mund të ndërtojnë një fletë prezantimi murale që përmban fjalorin e përdorur gjatë këtyre temave.

Përdorimi i internetit: Nxënësit do gjejnë diçka gazmore në këtë site interaktiv lidhur me mbrojtjen nga elektriciteti në kushtet e shtëpisë: [www.switchedonkids.org.uk/electrical-safety-in-your-home](http://www.switchedonkids.org.uk/electrical-safety-in-your-home).

Kjo video lidhet me rreziqet e mundshme gjatë përdorimit të rrjetit kryesor të energjisë elektrike: [www.bbc.co.uk/learningzone/clips/mains-power-and-the-danger-of-electricity/2195.html](http://www.bbc.co.uk/learningzone/clips/mains-power-and-the-danger-of-electricity/2195.html)

<b>Fusha:</b> Shkencë	<b>Lënda:</b> Dituri Natyre	<b>Klasa 2</b>	<b>Data</b>
<b>Tema mësimore:</b> Ndërtimi i qarkut (ora 1)		<b>Situata e të nxënit:</b> Si mund ta ndezësh llambën?	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Zbulon nga se përbëhet një qark elektrik.</li> <li>- Përshkruan rolin e secilit element të qarkut elektrik si dhe të sinjalizuesit.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b>		<b>Fjalë kyçe:</b> qark, llambë, lidhës, qark i mbyllur	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mëson përbërësit e qarqeve të thjeshtë që përdorin pila (bateri).</li> <li>- Mbledh prova nëpërmjet kryerjes së vëzhgimeve, ndërsa përpiqet që t'i përgjigjet një pyetjeje shkencore.</li> <li>- Përdor përvojën e drejtpërdrejtë për mësimin e përbërësve të qarkut.</li> <li>- Përdor burime të thjeshta të informacionit, kryen dhe regjistron vëzhgime.</li> <li>- Diskuton rreth rrezeve dhe mënyrave të shmangies së tyre.</li> </ul>			
<b>Burimet:</b> enciklopedi, ilustrime		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b>	
<b>Mjete:</b> bateri/pilë, tel përçues, llambë		Gjuhë (Gjuhë shqipe),	
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b>			
<p><i>Parashikim me terma paraprakë:</i> Paraqiten para nxënësve figurat (ose objektet) dhe emërtimet e bateri/pilë, tel përçues, llambë, mbajtëse e baterisë, mbajtëse e llambës. Pyeten nxënësit nëse i njohin ato dhe për se përdoren.</p> <p>U kërkohet nxënësve të krijojnë një lidhje ndërmjet këtyre figurave dhe ta tregojnë atë.</p> <p><i>Përmbledhje e strukturuar:</i> Pas tregimeve të nxënësve zhvillohet një prezantim i objekteve, funksionit të tyre dhe organizimit në një qark.</p> <p>Ftohen nxënësit të vëzhgojnë figurat e fq. 52 dhe 53 të librit. U shpjegohet nxënësve se është e rëndësishme që ndërtimi i qarkut të krijojë lak të mbyllur. Më pas kërkohet nga nxënësit që duke përdorur gishtat të ndjekin të njëjtën sekuençë veprimesh si në figurë, duke filluar nga pila. Shpjegohet që elektriciteti duhet të lëvizë në lakun e mbyllur përreth qarkut nga njëra anë e pilës, përgjatë telave përcjellës, të përshkruajë të gjithë përbërësit e qarkut dhe të kthehet përsëri në pilë.</p> <p><i>Lojë 1:</i> Përdoren shirita imitues për të ndërtuar një qark të madh të mbyllur në formë drejtkëndëshi në dysheme. Shpjegohet që shiriti imitues përfaqëson telat përcjellës dhe që ata do të jenë në rolin e elektricitetit. Kërkohet nga nxënësit të qëndrojnë në radhë përgjatë telave përcjellës. Zgjidhet një nxënës që të luajë rolin e pilës. Shpjegohet që pila mundëson lëvizjen e elektricitetit përreth qarkut. “Pila” do të qëndrojë në njërin anë të qarkut dhe t’i japë çdo nxënësi një shtytje të lehtë sa ta shkundë nga vendi. Pila do të thotë fjalën “shty” çdo herë që prek një nxënës. Nxënësit do të lëkunden përreth qarkut vetëm kur dëgjojnë “pilën” që shqipton fjalën “shty”. Zgjidhet një nga nxënësit e tjerë që të luajë rolin e llambës dhe të qëndrojë në anën e kundërt të pilës. Sa herë që elektriciteti lëviz, “llamba” duhet të ngrejë duart lart në ajër dhe të buzëqeshë për të treguar që është ndezur. Nëse elektriciteti ndalon, “llamba” duhet të ulë duart poshtë dhe të shtiret si e mërzitur.</p> <p><i>Lojë 2:</i> Përdoret i njëjti “qark” si ai i lojës së parë. Bëhet një e çarë e vogël në shiritin imitues të qarkut. U shpjegohet nxënësve që nuk lejohet kalimi i tyre nga njëra anë e të çarës në anën tjetër të saj dhe ata duhet të ndalojnë në anë të saj.</p>			

<p>Nxënësit duhet të kuptojnë që elektriciteti nuk mund të rrjedhë në një qark që nuk është i mbyllur. Ky veprim modelon mjaft mirë atë çfarë ndodh në një qark të vërtetë. Nxënësit luajnë rolin e elektroneve, pjesëzave të vogla brenda telit përcjellës. Kur një pilë lidhet me qarkun, tensioni i saj shtyn elektronet përreth përcjellësit, njëllor siç vepronin nxënësit e vendosur në radhë. Veprimi modelues mund të zgjerohet duke emërtuar pilën me një pol pozitiv dhe me një pol negativ. Kjo duhet të bëhet në mënyrë që elektronet të lëvizin nga poli negativ i pilës në drejtim të polit pozitiv të saj.</p> <p>Në fillim dhe në fund të çdo loje do të kujtohen rolet e secilës pjesë përbërëse të qarkut dhe dy rastet: kur qarku është i mbyllur (loja 1) dhe kur qarku nuk është i mbyllur (loja 2).</p> <p>I rëndësishëm është shpjegimi i faktit se elektriciteti i rrjetit kryesor të furnizimit është i rrezikshëm për shkak se “shtytja” është kaq e fortë sa elektriciteti mund të kalojë përmes ujit dhe madje përmes trupit të njeriut. Ky është shkakun pse njerëzit mund të pësojnë goditje elektrike. Nxënësit mund të ndërtojnë qarqe të ndryshme në <i>Fletën e punës 5.3a</i></p> <p><i>Diskutohet</i> së bashku fillimisht në dyshe dhe më pas me të gjithë klasën ndërtimi i qarqeve të punuara në fletët e punës.</p>	
<p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për prezantimin korrekt duke përdorur fjalorin e duhur në emërtimin e pjesëve përbërëse të një qarku dhe ndërtimin e tij.</p>	
Detyra: Vizatimi i skicës së një qarku si në <i>Fletën e punës 5.3a</i>	Refleksion:
<p><b>Shënim: Kujdes</b> kur nxënësit shtyjnë njëri-tjetrin për realizimin e lojës. Plotësohen në muralen e klasës emërtimet dhe shpjegimet e tyre e pjesëve përbërëse të një qarku</p>	

## Ora 28

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 2	Data
<b>Tema mësimore:</b> Ndërtimi i qarkut (ora 2)		<b>Situata e të nxënit:</b> Si mund ta ndezësh llambën?	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zbulon nga se përbëhet një qark elektrik.</li> <li>- Përshkruan rolin e secilit element të qarkut elektrik.</li> <li>- Ndërton një qark të thjeshtë elektrik.</li> </ul>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mëson përbërësit e qarqeve të thjeshtë që përdorin pila (bateri).</li> <li>- Mbledh prova nëpërmjet kryerjes së vëzhgimeve, ndërsa përpiqet që t'i përgjigjet një pyetjeje shkencore.</li> <li>- Përdor përvojën e drejtpërdrejtë për mësimin e përbërësve të qarkut.</li> <li>- Përdor burime të thjeshta të informacionit, kryen dhe regjistrojnë vëzhgime.</li> <li>- Parashikon se çfarë do të ndodhë përpara se të vendosë se çfarë do të bëjë.</li> <li>- Diskuton rreth rreziqeve dhe mënyrave të shmangies së tyre.</li> <li>- Përdor disa mënyra për t'u treguar të tjerëve çfarë ndodhi.</li> </ul>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> qark, llambë, lidhës, qark i mbyllur</p>	

<p><b>Burimet:</b> enciklopedi, ilustrime  <b>Mjete:</b> bateri/pilë, mbajtëse baterish, tel përçues, llambë, mbajtëse llambash, disa tela përçues.</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Art (Art pamor)</p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b>  <i>Prezantim i skicave</i> të punuara për detyrë nga nxënësit. Në dyshe nxënësit i tregojnë njëri tjetrit pjesët përbërëse të qarkut dhe si funksionojnë ato. Më pas dy prej tyre mund ti prezantojnë para klasës.  <i>Hetim:</i> Nxënësit do të punojnë në dyshe ose grup. Çdo grup ka pjesët e veta të qarkut. Nxënësit ftohen të provojnë lidhje të ndryshme të pjesëve të qarkut orientuar nga fleta e punës 5.3 b. Kërkohet që përpara se të provojnë lidhjen e qarkut të parashikojnë se çfarë do të ndodhë. Këtë parashikim do ta shkruajnë në fletën e punës 5.3 c dhe do t'ia tregojë shokut/shokëve të grupit. Nxënësi kryen lidhjen dhe krahason përfundimet me parashikimin “Llamba ndizet ose llamba nuk ndizet”.  Nxënësit me arritje më të larta mund të plotësojnë njëkohësisht dhe <i>Fletën e punës 5.3d</i>  <i>Përfundime:</i> Secili grup përshkruan një rast kur nga lidhja e pjesëve të qarkut llamba nuk u ndez dhe rastin kur llamba u ndez. Krahasohen skemat në të gjitha rastet e prezantuara nga grupet.</p>	
<p><b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për prezantimin korrekt duke përdorur fjalorin e duhur në emërtimin e pjesëve përbërëse të një qarku. Për përputhshmërinë e të gjitha qarqeve të ndërtuara nga grupet në lidhje me figurat.</p>	
<p><b>Detyra:</b> Punimi i fq. 29, <i>Fletore pune</i></p>	<p><b>Refleksion:</b> trego cili ishte momenti më i bukur gjatë hetimit që kreve.</p>
<p>Shënim: Nxënësit orientohen dhe me rastet e lidhjes së pjesëve të qarkut si në <i>Fletoren e punës</i> në fq. 29.  <b>Tregoni kujdes:</b> Udhëzohen dhe kontrollohen nxënësit në lidhje me qarqet e shkurtra: nëse ata lidhin një bateri me një tel të vetëm përcjellës, kjo mund të shkaktojë njëherazi tejnxehjen e baterisë dhe të përcjellësit.</p>	

## Ora 29

<p><b>Fusha: Shkencë</b></p>	<p><b>Lënda: Dituri Natyre</b></p>	<p><b>Klasa 2</b></p>	<p><b>Data</b></p>
<p><b>Tema mësimore:</b> Përdorimi i motorëve dhe sinjalizuesve</p>		<p><b>Situata e të nxënit:</b> Si të bëjmë një ventilator?</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zbulon nga se përbëhet një qark elektrik.</li> <li>- Përshkruan rolin e secilit element të qarkut elektrik si dhe të sinjalizuesit.</li> <li>- Tregon zbatime të qarqeve elektrike në shtëpi ose në klasë.</li> <li>- Ndërton një qark të thjeshtë elektrik.</li> <li>- Ndërton një lodër që përdor elektricitetin.</li> </ul>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Familjarizohet me pjesët e qarqeve të thjeshta që përdorin pilat (bateritë).</li> <li>- Mbledh prova nëpërmjet kryerjes së vëzhgimeve, ndërsa përpiqet që t'i përgjigjet një pyetjeje shkencore.</li> </ul>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> motor, sinjalizues</p>	



<ul style="list-style-type: none"> <li>- Parashikon se çfarë do të ndodhë përpara se të vendosë se çfarë do të bëjë.</li> <li>- Diskuton rreth rreziqeve të mundshme dhe mënyrës së shmangies së tyre.</li> <li>- Kryen dhe regjistron vëzhgime gjatë provave.</li> <li>- Bën krahasime ndërmjet motorit dhe sinjalizuesit.</li> <li>- Identifikon forma dhe veçori dalluese të thjeshta.</li> <li>- Diskuton rreth parashikimeve (me gojë ose me shkrim), rreth rezultatit dhe pse ka ndodhur kështu.</li> </ul> <p>Rishikon dhe shpjegon çfarë ka ndodhur.</p>	
<p><b>Burimet:</b> enciklopedi, ilustrime Mjete: bateri/pilë, mbajtëse baterish, tel përçues, motor, gërshërë, karton, gjilpëra me kokë</p>	<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b></p>
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b> <i>Diskutim për njohuritë paraprake:</i> Nxënësit shohin objekte të ndryshme që vihen në lëvizje nga motori si dhe sinjalizues, p.sh. ventilator, lodër, zile, celular. Parashikohet se çfarë do të bëjnë ato. Më pas vështrohen figurat në fq. 54 të Librit dhe diskutohet.</p> <p>U kërkohet nxënësve të mendojnë rreth pajisjeve të tjera shtëpiake që përdorin motorë. (Motorët elektrikë përdoren në shumë pajisje dhe mund të identifikohen duke dëgjuar për gumëzhitjen e tyre. Kompjuterat përdorin motorë për të vënë në lëvizje një ventilator dhe një hard disk, printerat përdorin motorë për të lëvizur letrën dhe kokat printuese, telefonat celularë përdorin motorë të vegjël të pabalancuar që shkaktojnë vibrimin e tyre. Nxënësit mund të identifikojnë makinat larëse, tharëset e flokëve, ventilatorët dhe kaçavidat elektrike si pajisje rrotulluese që përdorin motorë.)</p> <p>Bisedohet me nxënësit rreth pajisjeve elektrike shtëpiake që përdorin zile, psh. orët me alarm dhe zilet e dyerve. (Telefonat e thjeshtë celularë shpesh përdorin një lloj toni zileje por kanë një altoparlant për biseda më të qeta. Modelet më të ndërlikuar kanë një listë përzgjedhjeje për tonet e ziles dhe përdorin vetëm një altoparlant për të luajtur tonin e ziles. Ata mund të mos kenë në përdorim zile të thjeshta.)</p> <p>Prezantohet një model i thjeshtë (nga objektet e sjella) në mënyrë që nxënësit të shohin se çfarë ndodh në brendësi të tij.</p> <p><i>Veprimtari:</i> Në këtë veprimtari, llamba në një qark zëvendësohet me një motor. Nxënësit presin një fletë ventilatori dhe e ngjisin atë tek motori duke përdorur ngjitës plastik. Ata duhet të bashkojnë pilën dhe motorin me tela përcjellës. Kërkohet nga nxënësit të mbledhin prova duke vëzhguar ventilatorin me shumë kujdes për t'ju përgjigjur pyetjes: Në cilin kah rrotullohet ventilatori?</p> <p>Më pas ftohen nxënësit të parashikojnë se çfarë do të ndodhë nëse ata ndryshojnë mënyrën e lidhjes së telave përcjellës. Nxënësit mund të bëjnë parashikime të ndryshme. Ata e identifikojnë këtë me lehtësi duke zëvendësuar fletët e ventilatorit me fletët-spirale ose me fletët me shigjeta. Pas vendosjes në punë të ventilatorit, nxënësit do të shpjegojnë atë çfarë kanë zbuluar. Po të njëjtën veprimtari përsërisim me një sinjalizues. Nxënësit do të ndërtojnë një qark që mundëson funksionimin e një sinjalizuesi. Ata do të parashikojnë se çfarë do të ndodhë nëse ata ndryshojnë mënyrën e lidhjes së përcjellësve. (Disa nxënës tashmë mund ta kenë zbuluar që qarku i tyre nuk punon. Nxiten nxënësit që të identifikojnë faktin se sinjalizuesi punon vetëm kur lidhet në një drejtim të caktuar dhe ta krahasojnë këtë me motorin dhe llambën që punojnë pavarësisht mënyrës së lidhjes së përcjellësve).</p> <p><i>Ditari dyptjesësh:</i> Nxënësit do të punojnë në çift për të treguar në lidhje me llambën, motorin dhe sinjalizuesin faktit se përse dhe si përdoren ato. Disa prej dysheve do të përgjigjen përpara klasës.</p>	



<b>Vlerësimi:</b> Vlerësohen nxënësit për përcaktimin e saktë e me fjalorin e duhur të dallimeve ndërmjet llambës, motorit dhe sinjalizuesit	
<b>Detyra:</b> Punimi i fq. 30, <i>Fletore pune</i>	<b>Refleksion:</b> Duke u nisur nga përdorimi i tyre trego cilën pjesë elektronike preferon llambën, motori, apo sinjalizuesin.
<p><b>Shënim:</b> Nëse disa nga nxënësit me arritje më të ulëta po ndeshin vështirësi për të ndërtuar qarqet, kërkoni nga nxënësit e tjerë që të shpjegojnë se si bëhet kjo – por ata nuk duhet të ndërtojnë qarqet për ata nxënës.</p> <p>Përdorimi i internetit: Këtu jepen instruksione për mënyrën si të ndërtohet një motor i thjeshtë: <a href="http://www.wikihow.com/Build-a-Simple-Electric-Motor">www.wikihow.com/Build-a-Simple-Electric-Motor</a>.</p>	

### Ora 30

<b>Fusha: Shkencë</b>	<b>Lënda: Dituri Natyre</b>	<b>Klasa 2</b>	<b>Data</b>
<b>Tema mësimore:</b> Çelësat		<b>Situata e të nxënit:</b> Ndize, fike	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkruan rolin e secilit element të qarkut elektrik si dhe të sinjalizuesit.</li> <li>- Tregon zbatime të qarqeve elektrike në shtëpi ose në klasë</li> <li>- Ndërton një çelës për një qark elektrik të thjeshtë.</li> </ul>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mëson se si mund të përdoret një çelës për të shkëputur lidhjet e një qarku.</li> <li>- Përdor përvojën e drejtpërdrejtë në përdorimin e një çelësi në qark.</li> <li>- Parashikon se çfarë do të ndodhë përpara se të vendosë se çfarë do të bëjë.</li> <li>- Diskuton rreth rreziqeve të mundshme dhe mënyrës së shmangies së tyre.</li> <li>- Kryen dhe regjistron vëzhgime.</li> <li>- Rishikon dhe shpjegon atë çfarë ka ndodhur.</li> </ul>		<b>Fjalë kyçe:</b> çelës	
<p><b>Burimet:</b> enciklopedi, ilustrime Mjete: bateri/pilë, mbajtëse baterish, llambë/motor/sinjalizues, tre tela përçues.</p>		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b>	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <p><i>Diskutim për njohuritë paraprake:</i> Ftohen nxënësit të shohin objektet e shpërndara në grupet e tyre me nga 4-5 vetë. Objektet janë; llambë, disa tela përcjellës, një pilë/bateri.</p> <p>Drejtohet pyetja: Çfarë mund të bëhet me to?</p> <p><i>Hetim:</i> Nxënësit do të ndërtojnë një qark. Një nxënës do të mbajë një pilë, një tjetër një llambë. U kërkohet nxënësve të tjerë të qëndrojnë në një rreth, secili duke mbajtur nga një tel. Nxënësit udhëzohen se ata do të provojnë të ndërtojnë një qark të madh për të ndriçuar llambën. Kërkohet nga nxënësit që të bashkojnë telat e tyre me telat e nxënësve fqinjë, ku çdo nxënës të mbajë me dorë telat e vet. Telat duhet të lidhen me pilën si edhe me llambën gjithashtu. Kjo paraqet vështirësi për shkak sepse telat që mbahen nga nxënësit janë të shumtë në numër. Nëse nxënësit punojnë mirë së bashku, ata mund të bëjnë njëherazi bashkimet dhe të mundësojnë ndezjen e llambës. Llamba mund të ndizet, por më pas mund të fiket nëse një nga nxënësit lëviz dhe shkëput lidhjen.</p>			

*Diskutohet* me nxënësit pse llamba nuk është gjithmonë e ndezur. Nxiten ata që të shpjegojnë se nëse ka një shkëputje në qark, elektriciteti nuk mund të rrjedhë.

Prezantohen lloje të ndryshëm çelësash. Diskutohet për figurat e çelësave në fq. 56 të librit dhe kërkohet nga nxënësit që të thonë se përse përdoren këta çelësa.

Dy çelësat e parë mundësojnë ndezjen e llambave. I fundit në të majtë ndez një pajisje elektrike dhe i fundit në të djathtë ushqen një prizë elektrike. Më pas tregoni një çelës të vërtetë dhe shpjegoni që kur ai është në pozicioni “fikur” çelësi mundëson një shkëputje në qark; kur çelësi është në pozicionin “ndezur” ai mundëson mbylljen e qarkut.

Kujtohen nxënësit se qarqet që përdorin bateri mund të hetohen pa ndonjë rrezik, ndërsa elektriciteti i rrjetit kryesor të furnizimit jo. Nxënësit asnjëherë nuk duhet të prekin pajisjet që lidhen në rrjetin kryesor të furnizimit derisa një person i rritur t’u tregojë atyre se ato janë të sigurta. Kujtohen nxënësit që çelësat e rrjetit të furnizimit kryesor kurrë nuk duhet të preken me duar të lagura.

*Veprimtari 1:* Nxënësit do të ndërtojnë një qark ku të përdorin një çelës për të kontrolluar një llambë.

Diskutohet se ku mund të ishte i dobishëm ky qark, psh. për të kontrolluar dritat e fenerëve në një automobil, ose për të kontrolluar një llambë ndriçimi në tavanin e shtëpisë. Nxënësit do të bëjnë parashikime rreth asaj se çfarë do të ndodhë nëse përdorin një sinjalizues ose një motor në qark. Bisedohet rreth këtyre parashikimeve, më pas u jepet nxënësve kohën e mjaftueshme për të hetuar mbi saktësinë e parashikimit.

*Veprimtari 2:* Nxënësit do të punojnë bashkërisht si klasë për të ndërtuar një maket qyteti model. Duke përdorur qarqet e ndërtuara në veprimtarinë 1 ata do të ndërtojnë maketin e një qyteti. Përdoren modele të përgatitura më parë prej tyre të ndërtesave/ banesave duke vendosur në to qarqe me çelësa dhe me llamba për të kontrolluar ndriçimin brenda ose qarqe me sinjalizues për të kontrolluar zilet e dyerve apo pika alarmi dhe kryqëzime kalimtarësh e qarqe me motorë për të kontrolluar modelet e turbinave me erë.

*Prezantimi:* secili grup prezanton pjesën e tij të maketit. Këto pjesë bashkohet dhe në fund ndizen të gjithë çelësat në të për të treguar jetë brenda tij.

*Vlerësimi:* Bisedë me grupet e nxënësve rreth faktit se si po ndërtojnë qarqet e tyre të pajisura me çelësa. Kërkohet nga nxënësit të shpjegojnë funksionimin e qarqeve.

**Detyra:** Punimi i fq. 31, *Fletore pune*

-Nxënësit nëse dëshirojnë do të vizatojnë një pajisje elektrike që kanë në shtëpi dhe të emërtojnë çdo çelës, tel përçues ose llambë ndriçimi.

**Refleksion:** Duke u nisur nga përdorimi i tyre trego cilën pjesë elektronike preferon llambën, motori, apo sinjalizuesin.

**Shënim:** Nxënësit me arritje më të ulëta mund ndeshin vështirësi gjatë ndërtimit të qarqeve.

Kërkohet nga nxënësit e tjerë të shpjegojnë se si bëhet kjo, por të mos ndërtojnë qarqet për ata nxënës.

Nxënësve me arritje më të larta u kërkohet të parashikojnë se çfarë do të ndodhë në një qark me më shumë se një çelës. Më pas ata ndërtojnë qarkun për të kontrolluar parashikimet e tyre. -Në varësi të kohës veprimtaria e dytë mund të përfundohet në orën në vazhdim.

**Ora 31**

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 2	Data
<b>Tema mësimore:</b> Kontrolloni përparimin		<b>Situata e të nxënit:</b> unë di...	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zbulon nga se përbëhet një qark elektrik.</li> <li>Përshkruan rolin e secilit element të qarkut elektrik si dhe të sinjalizuesit.</li> <li>- Tregon se elektriciteti merret nga rrjeti ose nga bateritë.</li> <li>- Ndërton një qark të thjeshtë elektrik.</li> <li>- Vlerëson rolin e elektricitetit në jetën e përditshme.</li> <li>- Vlerëson zbatimin e rregullave të sigurisë gjatë punës me elektricitet.</li> </ul>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rishikon përmbajtjen e të gjithë mësimeve dhe veprimtarive të punuara.</li> </ul>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> pilë/ bateri qark, llambë, qark i mbyllur, motor, sinjalizues, çelës, elektriciteti, elektriciteti i rrjetit</p>	
<p><b>Burimet:</b> enciklopedi, muralja e klasës, ilustrime</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Arte (Art pamor)</p>	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <p><i>Parashikim me terma paraprakë:</i> prezantohen fjalët kyçe dhe nxënësit do të tregojnë lidhjen që ekziston ndërmjet tyre.</p> <p>Ftohen nxënësit të punojnë individualisht në plotësimin e fq. 58 dhe 59 të librit.</p> <p><i>Përfundimet</i> diskutohen në dyshe dhe më pas me gjithë klasën.</p> <p>Lojë: Ndërtimi i një interpretimi pa fjalë. Nxënësit ftohen të organizojnë në grup një interpretim pa fjalë i cili të tregojë njërin prej situatave: Fik-ndiz dritën; Zilja bie-pushoi; motori punon-u fik; Kujdes elektriciteti i rrjetit kryesor të furnizimit!</p> <p>Pas interpretimeve nxënësit e tjerë gjejnë situatën të cilën interpretuan shokët.</p>			
<p><b>Vlerësimi:</b> Për shkallën e përvetësimit të njohurive shkathësive dhe qëndrime gjatë këtyre mësimeve. Për prezantimin e saktë dhe në forma të ndryshme të mendimeve duke përdorur fjalorin e përshtatshëm. Për komunikimin me të tjerët të ideve të tyre.</p>			
<p><b>Detyra:</b> Trego në mënyrën tënde të preferuar, sa i rëndësishëm është për ty elektriciteti.</p>		<p><b>Refleksion:</b> Elektriciteti dhe ti</p>	
<p><b>Shënim:</b></p>			

## Kapitulli 6: Toka dhe Dielli

### Ora 32

<b>Fusha:</b> Shkencë	<b>Lënda:</b> Dituri Natyre	<b>Klasa 2</b>	<b>Data</b>
<b>Tema mësimore:</b> Dita dhe nata		<b>Situata e të nxënit:</b> Dita dhe nata	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkruan formimin e ditës dhe natës si pasojë e rrotullimit të Tokës rreth boshtit të saj.</li> <li>- Krijimin një maket që tregon formimin e ditës dhe natës si pasojë e rrotullimit të Tokës rreth boshtit të saj.</li> </ul> <p>Zbulon nëse lëviz Dielli apo Toka.</p>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Modelon dukurinë se rrotullimi i Tokës sjell ditën dhe natën, p.sh. duke përdorur topa të madhësive të ndryshme dhe një fener.</li> <li>- Identifikon forma dhe veçori dalluese të thjeshta.</li> </ul>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> rrotullohet, natë, ditë</p>	
<p><b>Burimet:</b> enciklopedi, ilustrime</p> <p><b>Mjete:</b> një glob ose një top futbollit, ngjitës shirit, një burim drite (një fener), një kukull, një rreth gjimnastikor</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Shkencat sociale (Gjeografi), Edukim fizik</p>	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <p><i>Harta e konceptit:</i> Në tabelën e klasës shkruhen fjalët: Toka, Dielli. Çfarë mund të thoni për to?</p> <p>Tregohen pamje të Tokës në hapësirë. Vëzhgohet figura e fq. 60 të librit. Flitet mbi pamjen dhe formën e tokës. Sqarohen nxënësit mbi faktin se është Toka që rrotullohet rreth vetes së saj për 24 orë. Kjo sjell formimin e ditës dhe natës.</p> <p><i>Veprimtari 1:</i> Nëpërmjet një topi dhe një ndriçuesi nxënësit do të imitojnë rrotullimin e Tokës rreth vetes dhe do të vëzhgojnë çfarë ndodh me ndriçimin e saj. Nxënësit mund të vizatojnë në top ose të ngjisin në dy anët e kundërta të topit dy kukulla. Para se të zhvillojnë veprimtarinë ata do të parashikojnë nëse do të jenë të ndriçuara në të njëjtën kohë të dyja kukullat? Pse? Me zhvillimin e veprimtarisë si në libër do të diskutohet për të dalë në përfundime: Kur në njërin anë të tokës ka dritë në tjetrën ka errësirë.</p> <p>Zhvillohet bisedë me nxënësit rreth të afërmeve që kanë në shtete të tjera të botës dhe si ndryshon kur në disa vende të botës është ditë, në disa të tjera është natë.</p> <p><i>Veprimtari 2:</i> Tre nxënës të qëndrojnë brenda një rrethi të madh plastik (gjimnastikor) me pamje nga jashtë rrethit dhe me rrethin e vendosur në belin e tyre. Zgjidhet një i nxënës i katërt që do të ndriçojë tre të tjetër me një fener. Nxënësi me fener duhet të rrijë pa lëvizur ndërsa nxënësit në rreth duhet të rrotullohen. Ndërsa rrethi rrotullohet, nxënësit brenda tij mund të tregojnë me gjeste se çfarë bëjnë ata në atë orë të ditës. Në anën e kundërt të dritës ata flenë, ndërsa kur vijnë e dalin në dritë ata zgjohen dhe shtrihen ose lajnë dhëmbët.</p>			

<p>Ndërsa i largohen dritës, nxënësit hanë ushqim dhe bëhen gati për të fjetur përsëri. Nxënësit mund të punojnë në grupe katërshë për të praktikuar dhe kryer këtë demonstrim. Punohen <i>Fletët e punës 6.1a</i> dhe <i>6.2b</i> e cila është e ngjashme me 6.1 a por është ndërtuar për t'u përdorur nga nxënësit me arritje më të larta. Atje kërkohet nga nxënësit që të përshkruajnë ndryshimin midis ditës dhe natës dhe të shkruajnë çfarë ata bëjnë në orare të ndryshme të ditës apo të natës.</p> <p><i>Parashikim me terma paraparakë:</i> Duke përdorur fjalët kyçe nxënësit ritregojnë kuptimin dhe lidhjen ndërmjet tyre.</p>	
<p><b>Vlerësimi:</b> Gjatë zhvillimit të veprimtarive zgjidhen nxënës të ndryshëm për të treguar atë çfarë po imitojnë me gje të tjerët dhe të thonë pse.</p>	
<p><b>Detyra:</b> Punimi i fq. 32, <i>Fletore pune</i> Nxënësit mund të tregojnë me vizatim më shumë veprimtari të tjera në periudha të ndryshme të ditës ose natës.</p>	<p><b>Refleksion:</b></p>
<p><b>Shënim:</b> Veprimtaria 2 mund të punohet edhe me grupe më të mëdha që qëndrojnë brenda një rrethi ose litari, ose thjesht me krahë të lidhura me njëri-tjetrin. Nxënësit e tjerë mund të qëndrojnë të palëvizur përreth dhe jashtë “Tokës” rrotulluese duke mbajtur lart në duar pan-karta që tregojnë kohën, të verdha për ditën dhe blu për natën.</p>	

### Ora 33

Fusha: Shkencë	Lënda: Dituri Natyre	Klasa 2	Data
<p><b>Tema mësimore:</b> A lëviz Dielli?</p>		<p><b>Situata e të nxënit:</b> Dita dhe nata</p>	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkruan formimin e ditës dhe natës si pasojë e rrotullimit të Tokës rreth boshtit të saj.</li> <li>- Zbulon nëse lëviz Dielli apo Toka.</li> </ul>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Eksploron faktin se Dielli duket sikur lëviz përgjatë ditës.</li> <li>- Mbledh prova nëpërmjet vëzhgimeve ndërsa përpiqet që t'i përgjigjet një pyetje shkencore.</li> <li>- Përdor përvojën e drejtpërdrejtë në vëzhgimin e diellit.</li> <li>- Bën sugjerime për mbledhjen e provave.</li> <li>- Bisedon rreth rreziqeve dhe mënyrave të shmangies së tyre.</li> <li>- Kryen dhe regjistron vëzhgime e matje të thjeshta të pozicionit të diellit.</li> <li>- Përdor disa mënyra për t'u treguar të tjerëve atë çfarë ndodhi.</li> <li>- Identifikon forma dhe veçori të thjeshta dalluese në lidhje me lëvizjen e diellit.</li> <li>- Rishikon dhe shpjegon atë çfarë ndodhi.</li> </ul>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> rrotullohet, natë, ditë</p>	
<p><b>Burimet:</b> enciklopedi, ilustrime</p> <p><b>Mjete:</b> një orë, ditë me diell, vizatim /foto e diellit</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Edukim fizik</p>	

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:**

*Diskutim për njohur paraprake:* Fëmijët në figurën e fq. 62 të librit kanë një problem. A mund t'i ndihmojmë ato duke treguar mendimin tonë? (Sqarohen nxënësit të kuptojnë që pyetja ka lidhje me faktin nëse Dielli lëviz nga një vend në një vend tjetër.)

*Veprimtari 1:* Për të vërtetuar mendimet e dhëna ftohen nxënësit të kryejnë vëzhgimet e tyre sipas veprimtarisë në fq. 63 të librit. Kërkohet nga nxënësit që të bëjnë sugjerime për të mbledhur prova rreth faktit nëse Dielli lëviz. Mund të dilet jashtë klasës dhe të vështrohet Dielli. U shpjgohet nxënësve se nëse Dielli lëviz shumë ngadalë ata mund të mos e vënë re lëvizjen.

Kërkohet nga ata që të mendojnë rreth faktit se si ne shohim ndryshime të tjera shumë të vogla, siç është rritja e bimëve. Planifikohet së bashku me nxënësit orari që të dalin në oborrin e shkollës për të parë pozicionin e Diellit gjatë ditës. Kërkohen sugjerime se çfarë mund të vëzhgojnë dhe çfarë mund të regjistrojnë. Nxënësit kryejnë matje të thjeshta duke regjistruar kohën në çastin që ata vëzhgojnë pozicionin e Diellit.

Përpara vëzhgimit të pozicionit të Diellit, bisedohet me nxënësit që Dielli nuk duhet të shihet drejtpërsëdrejti me sy të lirë. Tregohet rreth rreziqeve të mundshme dhe mënyrës së shmangies së tyre.

Bisedohet rreth asaj çfarë kanë vëzhguar ata. Dielli lëviz përgjatë qiellit. Shpjgohet fakti që kjo ndodh për shkak se Toka rrotullohet nuk është Dielli që lëviz.

Pyes nxënësit nëse kanë hipur ndonjëherë në ndonjë lodër rrotulluese. Kërkohet nga nxënësit që të shpjgojnë për të tjerët se çfarë shohin ata në lodrën rrotulluese kur ajo rrotullohet ose kur ata qëndrojnë në një vend dhe rrotullohen rreth vetes. Duhet sikur e gjithë bota rrotullohet rreth tyre. Por në të vërtetë lëviz nxënësi dhe jo bota. Shpjgohet që e njëjta gjë ndodh me Diellin. Toka rrotullohet rreth vetes kështu që duket sikur Dielli lëviz. Nëse është e mundur, përdoret një karrige rrotulluese për t'u dhënë nxënësve mundësinë që të përjetojnë personalisht ndjenjën e rrotullimit.

*Veprimtari 2:* Kërkohet nga nxënësit që të supozojnë se koka e tyre është Toka. Vendoset në murin e klasës një figurë të madhe të Diellit dhe u kërkohet nxënësve që të kthehen në mënyrë të tillë që gjatë rrotullimit (nga lindja në perëndim) të shohin nga pak diellin deri sa të drejtohen përball tij. Më pas nxënësit të vazhdojnë rrotullimin me ngadalë në mënyrë që Dielli të duket se lëviz në drejtim të perëndimit. Ata duhet të kryejnë një gjysmë rrotullimi. Nëse ata vazhdojnë rrotullimin Dielli zbret poshtë. Ata nuk mund ta shohin Diellin përsëri derisa të kenë bërë një gjysmë rrotullimi tjetër dhe Dielli të ngrihet përsëri në lindje. Sqarohen nxënësit se ky ishte një demonstrim më të thjeshtë i faktit pse Dielli duket sikur lëviz përgjatë qiellit.

*Përfundime:* Nxënësit plotësojnë *Fletën e punës 6.2b*. Kjo kërkon nga nxënësit që të bëjnë krahasime dhe lidhje të thjeshta duke vizatuar çfarë bëjnë ata kur errësohet dhe kur bëhet dritë në mëngjes. Shpjgohet fakti se si duket dielli se lëviz në vizatimet e dhëna. Këto plotësime diskutohen në dyshe ose grupe të vogla.

**Vlerësimi:** Vlerësohet shpjgimi mbi faktin se si Dielli duket se lëviz në qiell. Vlerësohen diskutimet e nxënësive rreth mendimeve të tyre kur çdo grup prezanton shpjgimin e vet përpara klasës.

**Detyra:** Punimi i fq. 33, *Fletore pune*  
Nxënësit plotësojnë *Fletën e punës 6.2a*.

**Refleksion:** Cili pozicion i diellit gjatë ditës të pëlqen më shumë?

**Shënim:**

**Kujdes:** Nxënësit duhet të paralajmërohen që në asnjë rast nuk duhet ta shohin Diellin drejtpërdrejt me sy të lirë, pasi kjo mund të dëmtojë sytë e tyre. Nxirren nxënësit jashtë klasës për të identifikuar forma dhe veçori të tjera dalluese duke vizatuar pozicionin e Diellit të paktën tre herë në ditë. Ndryshimet do të jenë më të qarta nëse kjo punë kryhet herët në mëngjes, në mes dhe në fund të ditës së shkollës. Nxënësit mund të përdorin *Fletën e punës 6.2a* për të regjistruar krahasimet e tyre. Në figurën e asaj flete mund të shtohen edhe elementë të tjerë që pasqyrojnë ambientin rreth shkollës me qëllim që të ndihmohen nxënësit që të pozicionojnë vizatimet e tyre të Diellit në atë figurë.

**Ora 34**

<b>Fusha:</b> Shkencë	<b>Lënda:</b> Dituri Natyre	<b>Klasa 2</b>	<b>Data</b>
<b>Tema mësimore:</b> Ndryshimi i hijeve		<b>Situata e të nxënit:</b> A lëvizin hijet?	
<b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b>			
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Demonstron se hija ndryshon madhësinë dhe formën si pasojë e rrotullimit të Tokës rreth boshtit.</li> </ul>			
<b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b>		<b>Fjalë kyçe:</b> e pasaktë	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Eksploron faktin e ndryshimit të pozicionit dhe të madhësisë së hijeve.</li> <li>- Mbledh prova nëpërmjet kryerjes së vëzhgimeve ndërsa përpiqet që t'i përgjigjet një pyetjeje shkencore.</li> <li>- Përdor përvojën e drejtpërdrejtë për mbledhjen e provave.</li> <li>- Formulon pyetje dhe sugjeron mënyra përgjigjeje për to.</li> <li>- Parashikon se çfarë do të ndodhë përpara se të vendosë se çfarë do të bëjë.</li> <li>- Mëson faktin se një test apo krahasim mund të mos jetë i drejtë.</li> <li>- Bën sugjerime për mbledhjen e provave.</li> <li>- Diskuton rreth rreziqeve të mundshme dhe mënyrave të shmangies së tyre.</li> <li>- Kryhen matje të thjeshta dhe regjistron vëzhgime.</li> <li>- Identifikon forma dhe veçori dalluese të thjeshta në lidhje me ndryshimin e hijes në varësi nga dielli.</li> </ul>			
<b>Burimet:</b> enciklopedi, ilustrime		<b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Edukim fizik	
<b>Mjete:</b> shkumës, ditë me diell, dy lapsa, plastelinë një orë, disa kube/kopsa/monedha me madhësi të njëjtë, një fletë e madhe letre			
<b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b>			
<p><i>Diskutim për njohur paraprake:</i> Çfarë mbani mend nga vizatimi i hijeve në mësimet e mëparshme? Si mendoni ju “A lëvizin hijet?”</p> <p>Kërkohet nga nxënësit që të parashikojnë se çfarë do të ndodhë me hijet e tyre. Nxiten të formulojnë pyetje rreth faktit se si mund të ndryshojnë hijet e tyre. Disa nxënës mund të japin mendimet e tyre ndërkohë të tjerë tregojnë nëse pajtohen me parashikimet ose jo. Nxiten nxënësit të ndërtojnë pyetje rreth çfarë do të ndodhë dhe pse.</p>			



*Veprimtaria 1:* Organizohen nxënësit që të dalin jashtë klasës disa herë në ditë dhe të vizatojnë me shkumës çdo herë konturin e hijes së vetvetes. Kërkohet nga nxënësit që të mendojnë pse është i rëndësishëm pozicionimi në të njëjtin vend për çdo herë. Nxiten nxënësit që të mendojnë se testimi nuk do të jetë i drejtë nëse nuk respektohet ky kusht.

Kërkohet nga nxënësit që të vëzhgojnë me kujdes pozicionin e çdo hijeje. A mund të shohin ata se pozicioni i çdo hijeje ka ndryshuar për çdo herë që ata dalin jashtë klasës? Çdo herë që dalin jashtë klasës kërkohet nga nxënësit që të tregojnë me një rën dorë hijen e vet dhe me dorën tjetër të tregojnë Diellin. Tërhiqet vëmendja rreth faktit se gjithmonë këto drejtime janë të kundërta me njëra-tjetrën. Kjo do t'i ndihmojnë nxënësit që të vënë re lidhjen midis tyre. Nxënësit duke vizatuar hije të ndryshme dhe duke vëzhguar ndryshimin e tyre përgjatë gjithë ditës.

Përpara vëzhgimit të pozicionit të Diellit, bisedoni me nxënësit rreth faktit se Dielli nuk duhet të shihet drejtpërsëdrejti me sy të lirë.

Frohen nxënësit të shohin figura e orës diellore në fq. 64 të Librit. Tregohet se për çfarë shërben dhe si funksionon ajo.

*Veprimtaria 2:* Nxënësit do të masin hijen e një lapsi përgjatë gjithë ditës për të parë ndryshimin e gjatësisë së hijes. Për hedhjen e të dhënave përdoret fleta e punës 6.3. Nxënësit me arritje më të ulëta kanë nevojë që të përdorin si njësi matëse jo-standarde objekte më të mëdhenj se zakonisht (numërorë të mëdhenj, kuti shkrepsësh bosh, fshirëse prej goma identike dhe të papërdorura etj.)

Nxënësit me arritje më të larta mund të masin gjatësinë e hijes së lapsit të tyre në saktësinë e centimetrave.

Përfundime: nga vëzhgimet e bëra nxiten nxënësit të tregojnë mbi ndryshimin e formës së hijeve dhe lidhjen e këtij ndryshimi me pozicionin e diellit. Ndihmohen ata që të identifikojnë veçoritë dalluese në rezultatet e marra. Hijet e matura do të shkurtohen afër mesditës dhe më pas do të fillojnë që të zgjaten përsëri.

**Vlerësimi:** Vlerësohen për zhvillimin e veprimtarive kërkuese, pyetjet që ngritën dhe shpjegimet argumentuese që dhanë.

**Detyra:** Punimi i fq. 34, *Fletore pune*

-Nëse nxënësit kanë në shtëpi aparate digjitale, kërkohet nga ata që të fotografojnë hijet e tyre të gjata të vetvetes të marra në orët e mbrëmjes dhe të sjellin figurat në shkollë për t'i treguar dhe diskutuar me të tjerët. Qartësohet fakti se nxënësit duhet të marrin leje nga të rriturit në shtëpi për të përdorur aparatet digjitale.

**Refleksion:**

**Shënim:** Nxënësit mund të përdorin një aparat digjital për të fotografuar shenjat e shkumës dhe hijet e marra për çdo orë. Këto fotografi mund të shikohen me nxënësit dhe të diskutohen më pas në klasë.

Veprimtaria 2 mund të jepet për detyrë të zhvillohet e plotë në shtëpi.

**Kujdes:** Nxënësit duhet të paralajmërohen që në asnjë rast nuk duhet ta shohin Diellin drejtpërsëdrejti me sy të lirë, pasi kjo mund të dëmtojë sytë e tyre.



**Ora 35**

<b>Fusha:</b> Shkencë	<b>Lënda:</b> Dituri Natyre	<b>Klasa 2</b>	<b>Data</b>
<b>Tema mësimore:</b> Kontrolloni përparimin tuaj		<b>Situata e të nxënit:</b> unë di...	
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkruan formimin e ditës dhe natës si pasojë e rrotullimit të Tokës rreth boshtit të saj.</li> <li>- Zbulon nëse lëviz Dielli apo Toka.</li> <li>- Demonstron se hija ndryshon madhësinë dhe formën si pasojë e rrotullimit të Tokës rreth boshtit.</li> </ul>			
<p><b>Rezultatet e të nxënit sipas temës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rishikon përmbajtjen e të gjithë mësimeve dhe veprimtarive të punuara.</li> </ul>		<p><b>Fjalë kyçe:</b> Toka, Dielli, Toka rrotullohet, hija</p>	
<p><b>Burimet:</b> enciklopedi, muralja e klasës, ilustrime</p>		<p><b>Lidhja me fushat e tjera:</b> Arte (Art pamor)</p>	
<p><b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</b></p> <p><i>Parashikim me terma paraprakë:</i> prezantohen fjalët Toka, Dielli, Toka rrotullohet, dita, nata dhe nxënësit do të tregojnë lidhjen që ekziston ndërmjet tyre.</p> <p>Ftohen nxënësit të punojnë individualisht në plotësimin e fq. 66 dhe 67 të librit.</p> <p><i>Përfundimet</i> diskutohen në dyshe dhe më pas me gjithë klasën.</p> <p>Ftohen nxënësit të tregojnë dhe luajnë lojën e tyre më të preferuar të zhvilluar gjatë këtyre orëve.</p>			
<p><b>Vlerësimi:</b> Për shkallën e përvetësimit të njohurive shkathtësive dhe qëndrime gjatë këtyre mësimeve. Për prezantimin e saktë dhe në forma të ndryshme të mendimeve duke përdorur fjalorin e përshtatshëm. Për komunikimin me të tjerët të ideve të tyre.</p>			
<b>Detyra:</b>		<b>Refleksion:</b>	
<b>Shënim:</b>			